



Doracak për nismat e bashkëpunimit rajonal në Evropën Juglindore



E drejta autoriale © 2013. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç për citim të pasazheve të shkurtra për qëllime të kritikave dhe shqyrtimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, as të ruhet në një sistem arkivimi, ose të transmetohet në çfarëdo forme ose përmes çfarëdo mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar apo tjetër, pa lejen paraprake me shkrim të KCSF-së.

PËRGATITUR NGA

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)

Ky doracak është përgatitur si pjesë e projektit “Rritja e pjesëmarrjes dhe e përfaqësimit rajonal të Kosovës” nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në bashkëpunim me Këshillin Britanik, mbështetur nga projekti KSTalksEU. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e vetme e KCSF-së dhe në asnjë rreth-anë nuk pasqyron qëndrimin apo pikëpamjet e Këshillit Britanik apo të organizatave të lidhura me të.

Lista e shkurtesave:

BP - Ballkani Perëndimor

CEFTA - Marrëveshja për Tregti të Lirë e Evropës Qendrore

DPPI - Nisma për Gatishmëri dhe Parandalim të Katastrofave

EC - Komisioni Evropian

ECAA - Hapësira e Përbashkët Evropiane e Aviacionit

ERI SEE - Nisma e Kërkimit në Arsim në Evropën Juglindore

EU - Bashkimi Evropian

MARRI - Nisma Rajonale për Migracionin, Refugjatët dhe Azilin

PCCSEE - Konventa për Bashkëpunim Policor për Evropën

Juglindore

RACVIAC - Qendra Rajonale për Asistim, Verifikim dhe Kontroll të Armëve

RAI - Nisma Rajonale Kundër Korrupsionit

RCC - Këshilli për Bashkëpunim Rajonal

RESPA - Shkolla Rajonale e Administratës Publike

RRDSWG - Grupi i Përhershëm Punues për Zhvillim Rural Rajonal në Evropën Juglindore

SEECF - Procesi i Bashkëpunimit në Evropën Juglindore

SEEHN - Rrjeti për Shëndetësi në Evropën Juglindore

SEEIC - Komisioni për Investime i Evropës Juglindore

SEETO - Observatori i Transportit i Evropës Juglindore

SELEC - Qendra për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore

UNMIK - Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

Përmbajtja:

Lista e shkurtesave:.....	4
Kapitulli I	7
Hyrje	9
1.1 Bashkëpunimi rajonal në EJT dhe në Kosovë	10
1.2 Objektivat	13
1.3 Metodologjia.....	14
1.4 Plani i doracakut	15
Kapitulli II	17
Konfigurimi i bashkëpunimit rajonal	19
2.1 Procesi i Bashkëpunimit i Evropës Juglindore -SEECP (struktura e bashkëpunimit politik)	19
2.2 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal - RCC (struktura operative që shërben si krah operativ i SEECP-it)	21
2.3 Task forcat dhe nismat rajonale.....	23
Kapitulli III	25
Fusha e zhvillimit ekonomik dhe social	27
3.1 Komisioni për Investime i Evropës Juglindore (SEEIC) - Sarajevë.....	27
3.2 Marrëveshja për Tregti të Lirë e Evropës Qendrore - CEFTA 2006, Bruksel.....	30
3.3 Rrjeti Shëndetësor për EJT (SEEHN) – Shkup.....	32
3.4 Grupi i Përhershëm Punues për Zhvillim Rural Rajonal në Evropën Juglindore (SEE RDSWG) - Shkup.....	34
Kapitulli IV	39
Transporti dhe infrastruktura	39
4.1 Traktati i Komunitetit të Energjisë (TKE)- Sekretariati në Vjenë	39
4.2 Observatori i Transportit për Evropën Juglindore (SEETO) - Beograd.....	42
4.3 Hapësira e Përbashkët Evropiane e Aviacionit (ECAA) - Bruksel	46
Kapitulli V	49
Drejtësia dhe punët e brendshme	51
5.1 Nisma Rajonale për Migracionin, Refugjatët dhe Azilin (MARRI) - Shkup.....	51

5.2 Nisma Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI) – Sarajevë.....	53
5.3 Qendra për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore (SELEC) - Bukuresht.....	56
Kapitulli VI	59
Bashkëpunimi për çështje të sigurisë	61
6.1 Nisma për Përgatitje dhe Parandalim ndaj Katastrofave (DPPI) - Sarajevë.....	61
6.2 Konventa për Bashkëpunim Policor për Evropën Juglindore (PCCSEE) – Lubjanë	64
6.3 RACVIAC/ Qendra për Bashkëpunim në Fushën e Sigurisë në Evropën Juglindore– Rakitje, Zagreb	67
Kapitulli VII	71
Ndërtimi i kapitalit njerëzor	73
7.1 Task Forca e RCC-së për Edukimin dhe Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor - Vjenë..	73
7.2 Nisma për kërkime arsimore në Evropën Juglindore (ERI SEE) - Beograd.....	74
7.3 Shkolla Rajonale e Administratës Publike (ReSPA) - Danilovgrad	78
Kapitulli VIII	83
Bashkëpunimi parlamentar	83
8.1 Kryetarët e Parlamentit të shteteve të SEECP-së.....	83
8.2 Sekretariati Rajonal për Bashkëpunim Parlamentar në Evropën Juglindore (RSPC SEE) - Sofje	84
8.3 COSAP-Konferenca për Ballkanin Perëndimor e Komisioneve Parlamentare të Integritimit Evropian të shteteve pjesëmarrëse në Procesin e Stabilizim-Asociimit .	85
8.4 Forumi Parlamentar i Cetinës (CPF) - Podgoricë	87
Kapitulli IX	89
Dekada Rome	91
9.1 Dekada e përfshirjes së romëve 2005 – 2015 - Dekada Rome - Budapest.....	91
Kapitulli X	97
Shtojca I	97
Pjesëmarrja e Kosovës në nismat rajonale	99
Shtojca II: teksti i marrëveshjes për përfaqësim rajonal të Kosovës	101
Marrëveshjet në lidhje me përfaqësimin dhe bashkëpunimin rajonal	101

Hyrje



Kapitulli I

Hyrje

Bashkëpunimi rajonal është një element qendror i përpjekjeve të Bashkimit Evropian për të sjellë përpara procesin e reformave në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe për të ndihmuar rajonin që të arrijë prosperitetin ekonomik dhe stabilitetin politik. Konfigurimi i tij politik dhe operativ ka evoluar dhe ende është duke evoluar varësisht nga dinamika politike dhe ekonomike në terren. Ky doracak ka për qëllim t'u shërbejë nëpunësve civilë dhe mediave që merren me çështjet rajonale dhe t'u ofrojë atyre informacion të plotë mbi strukturën, aktivitetet e mekanizmave dhe finan-cimin e tyre. Ky kapitull jep një pamje të përgjithshme mbi temat, të cilat trajtohen në këtë doracak. Në kuadër të kësaj pjese trajtohen temat e mëposhtme:

- **Bashkëpunimin rajonal në Evropën Juglindore**
- **Objektivat**
- **Metodologjia**
- **Plani i doracakut**

1.1 Bashkëpunimi rajonal në EJL dhe në Kosovë

Bashkëpunimi rajonal është kusht për anëtarësim në BE, si dhe komponent kyç i Procesit të Stabilizim-Asociimit (PSA), i cili i udhëheq vendet e Ballkanit Perëndimor drejt Bashkimit Evropian (BE). Në vitin 1999, komuniteti ndërkombëtar shpalli Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore si përgjigje të parë gjithëpërfshirëse që synon forcimin e përpjekjeve të të gjitha vendeve të Evropës Juglindore (EJL) në nxitjen e paqes, të demokracisë, respektit për të drejtat e njeriut dhe prosperitetin ekonomik. Pakti i Stabilitetit siguroi një kornizë për të nxitur bashkëpunimin rajonal dhe për të përsheptuar integrimin në strukturat evropiane dhe euroatlantike. Pronësia rajonale shënoi një epokë të re në skemat e bashkëpunimit rajonal pasi që Këshilli për Bashkëpunim Rajonal e mori këtë detyrë në vitin 2008 nga Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore.¹

Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC) ka trashëguar mandatin nga Pakti i Stabilitetit për të mbikëqyrur procesin e bashkëpunimit në Evropën Juglindore dhe për të mbështetur integrimin evropian dhe euroatlantik në rajon. Sekretariati i RCC-së, me seli në Sarajevë, tani vepron si një strukturë në pronësi dhe nën udhëheqje rajonale, dhe përqendrohet në promovimin dhe rritjen e bashkëpunimit rajonal në Evropën Juglindore duke mbështetur integrimin evropian dhe euroatlantik të vendeve aspiruese. RCC-ja

¹ <http://www.stabilitypact.org/>

i ofron kapacitetet operative dhe punon nën drejtimin politik të Procesit të Bashkëpunimit në Evropën Juglindore (SEECp). RCC-ja funksionon si pikë kryesore për bashkëpunim rajonal në EJK dhe roli i saj kyç është të gjenerojë dhe të bashkërendojë projektet zhvillimore të një karakteri më të gjerë rajonal, dhe të krijojë një klimë të përshtatshme politike të favorshme për zbatimin e tyre.

Ku qëndron Kosova në aspektin e bashkëpunimit rajonal?

Në vitin 2003, me Agjendën e Selanikut të BE-së, Kosova ishte përfshirë në proceset rajonale të BE-së për Ballkanin Perëndimor. Në vitin 2006, Kosova ka qenë e përfaqësuar nga UNMIK-u në shumë nisma, përderisa në vitin 2008, me shpalljen e Pavarësisë, ajo bën përpjekje të përfaqësohet në nismat rajonale në mënyrë të barabartë me vendet e tjera. Marrëveshja për pjesëmarrje dhe përfaqësim rajonal e 24 shkurtit 2012² ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit ka siguruar modalitetet për aplikim në një numër nismash, ku Kosova ka fituar pjesëmarrjen, të tilla si: Kompakti i Investimeve i EJK-së, Qendra e Evropës Juglindore për Mësimnxënie të Ndërmarrësisë, Grupi i Përhershëm Punues për Zhvillim Rural Rajonal për EJK, Qendra për Zhvillimin e Qeverisjes Elektronike, Rrjeti i Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të EJK-së, Iniciativa Elektronike e Evropës Juglindore + Iniciativa Broadband e Evropës Juglindore, Rrjeti Mjedisor Rajonal për Anëtarësim, Grupi Punues për Edukimin dhe Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor, Marrëveshja e Përbashkët Evropiane për Aviacion, Sekretariati i

² Referohu shtojcës II.

Programit ISIS (ECAA), Observatori i Transportit i Evropës Juglindore dhe Komuniteti për Energji.

Pas marrëveshjes së arritur në Bruksel ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Kosova tani është anëtare e plotë e një numri të organizatave rajonale dhe është në proces të përfshirjes zyrtare në disa nisma të tjera rajonale. Sa i përket përfshirjes së Kosovës në nismat rajonale, është me rëndësi të përmendet vendimi, i cili është marrë në mënyrë unanime nga Bordi i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC) më 17 janar 2013, me të cilin Kosova është bërë pjesëmarrëse e RCC-së.

Përveç kësaj, Kosova është gjithashtu anëtare e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit, Marrëveshjes për Tregti të Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), Unionit Ndërkombëtar të Transportit dhe Rrugëve (IRU), Traktatit të Komunitetit të Energjisë të Evropës Juglindore (ECSEE), dhe Forumit Ekonomik të Vjenës.

Kosova është pjesëmarrëse në një numër nismash me karakter rajonal – jashtë RCC-së – siç janë: Grupi i Vishegradit, Forumi i Odave Ekonomike të Adriatikut dhe Jonit, Korniza e Investimeve në Ballkanin Perëndimor dhe Procesi i Bërdos.

Aktualisht Kosova është në proces të anëtarësimit në: Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore, Komisionin Ndërkombëtar të Pellgut të Lumit Sava, Rrjetin e Grave Ndërmarrëse, Qendrën për Bashkëpunim të Sigurisë (RACVIAC), të Iniciativës Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI), Qendrën Rajonale të Punëdhënësve të

Adriatikut (AREC), Qendrën Rajonale Mjedisore për Evropën Jugore dhe Qendrore (REC), Bordin Këshillëdhënës të Prokurorëve të Evropës Juglindore (SEEPAG), Nismën Rajonale për Migracionin, Refugjatët dhe Azilin (MARRI), Konventën për Bashkëpunim Policor (PCCSEE), Iniciativën e Përgatitjes dhe Parandalimit të Katastrofave (DPPI) dhe në Rrjetin Shëndetësor (SEEHN).

1.2 Objektivat

Ky doracak është hartuar kryesisht për të ndihmuar punën e administratës publike dhe mediet në çështjet lidhur me bashkëpunimin rajonal të Kosovës. Doracaku ka tre objektiva:

1. Të mbështesë nëpunësit civilë për informacionet më të fundit mbi objektivat, sfondin/të kaluarën, kontaktet dhe strukturën e nismave të bashkëpunimit rajonal në Evropën Juglindore, ku Kosova mund të përfitojë nga anëtarësimi i saj.
2. Të ofrojë informacion të plotë dhe të strukturuar mbi konfiguracionin politik dhe operativ të bashkëpunimit rajonal në EJL.
3. Të informojë mbi “modus operandi” të nismave specifike rajonale të ndara në gjashtë sektorë, të cilat mbulojnë ekonominë dhe çështjet sociale, energjinë dhe transportin, zhvillimin e kapitalit njerëzor, sigurinë, drejtësinë dhe punët e brendshme dhe bashkëpunimin parlamentar.

Po ashtu, duke cituar karakteristikat kryesore të çdo nisme, lokacionin, anëtarësinë dhe strukturat rajonale.

Ky manual identifikon nismat kryesore rajonale, ku Kosova tashmë është anëtare ose kërkon anëtarësimin, dhe i jep një perspektivë gjithëpërfshirëse në sferat e punës dhe veprimtaritë e çdo nisme rajonale. Përveç kësaj, doracaku ka për qëllim të ndihmoj edhe mediet, të cilat raportojnë dhe shkruajnë për pjesëmarrjen e Kosovës në nismat rajonale. Gjithashtu, nga ky doracak mund të kenë përfitim edhe zyrtarët e BE-së, politikanët, shoqëria civile dhe trupi diplomatik, të cilët mund të përdorin informata specifike të ofruara në këtë doracak. Po ashtu, nëse Kosova synon të krijojë kontakte dhe të aplikojë në disa nga këto nisma, ky doracak ofron informata bazike në lidhje me kontaktet, strukturën dhe kushtet e anëtarësimit në këto nisma rajonale.

1.3 Metodologjia

Ky manual mbështetet në disa burime të informacionit. Informatat e para dhe më të rëndësishme janë mbledhur nga hulumtimet, informatat e rëndësishme nga faqet e internetit të Paktit të Stabilitetit për EJK-në, Këshillit për Bashkëpunim Rajonal dhe nga faqet e tjera të internetit të nismave rajonale. Informatat janë mbledhur po ashtu edhe gjatë bisedave dhe shkëmbimit të informatave me zyrtarë përkatës nga BE-ja dhe nismat rajonale, si

dhe me ekspertë që punojnë në sektorë të veçantë të mbuluar nga ky doracak. Për përmbajtjen dhe saktësinë e tyre është konsultuar gjithashtu edhe Ministria e Punëve të Jashtme e Qeverisë së Kosovës. Në mënyrë që ta bëjnë atë më gjithëpërfshirës, autorët kanë zgjedhur që të përfshijnë vetëm informatat faktike të fundit, të cilat veçanërisht do të jenë në shërbim të nëpunësve civilë. Ky manual nuk ofron analizë apo vlerësim të nismave rajonale dhe të pjesëmarrjes së Kosovës në to.

1.4 Plani i doracakut

Doracaku mbulon konfigurimin e plotë të bashkëpunimit rajonal me tri shtresat e tij apo skemat rajonale në të cilat më së miri mund të perceptohet bashkëpunimi rajonal. E para është shtresa politike e përshkruar nga Procesi i Bashkëpunimit në Evropën Juglindore (SEECp); e dyta është shtresa operative – Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC-ja) dhe e treta, janë celulat e vogla të shpërndara nëpër rajon – nismat rajonale të ndara në gjashtë sektorë. Të gjitha këto skema janë të ndërlidhura.


Ato janë zgjedhur duke përdorur fushat e veprimtarisë së RCC-së dhe lidhjes së tyre me nismat rajonale. Për më tepër, Dekada e Romëve si nismë rajonale është shtuar gjithashtu si një prej prioriteteve të qeverisë në lidhje me pjesëmarrjen rajonale.

Konfigurimi i bashkëpunimit rajonal



Kapitulli II

Konfigurimi i bashkëpunimit rajonal



2.1 Procesi i Bashkëpunimit i Evropës Juglindore -SEECp³ (struktura e bashkëpunimit politik)

Në vitin 1996, me nismën e Bullgarisë është krijuar Procesi i Bashkëpunimit i Evropës Juglindore (SEECp). SEECp-i është forum politik, i cili ka filluar në Sofje në vitin 1996. Si një nismë “autoktone”, SEECp-i kërkon ta përcaktojë veten si një zë autentik

³ Të gjitha informatat mbi SEECp janë marrë nga faqja e internetit: <http://rpscsee.org/en/pages/read/about-seecp>

i Evropës Juglindore. Ajo ka kryesim rotativ nga 12 shtete pjesëmarrëse dhe shërben si ombrellë politike e RCC-së. Në takimin e kryesuar nga Bullgaria, në Sofje, shtetet e RCC-së hodhën themelet për bashkëpunim rajonal me qëllim të krijimit të një atmosfere të besimit, të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe stabilitetit.⁴

Qëllimet themelore të bashkëpunimit rajonal në kuadër të SEEC-it përfshijnë forcimin e sigurisë dhe të gjendjes politike, intensifikimin e marrëdhënieve ekonomike dhe bashkëpunimin në burimet njerëzore, demokracinë, drejtësinë, dhe luftimin e veprimtarive të paligjshme. SEEC-i ka për qëllim t'ua mundësojë anëtarëve të saj qasjen në strukturat evropiane dhe euroatlantike përmes forcimit të marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe transformimit të rajonit në një zonë të paqes dhe të stabilitetit.⁵

Ky trup ishte thjesht një forum politik, i cili kishte nevojë për përcjellje aktive të premtimeve politike. Prandaj, në vitin 2008, me kalimin nga Pakti i Stabilitetit në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal, SEEC-ja vepron si një ombrellë politike e Sekretariatit të RCC-së.

⁴ Ibid iii

⁵ Ibid iii

2.2 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal - RCC⁶ (struktura operative që shërben si krah operativ i SEECP-it)

Këshilli për Bashkëpunimin Rajonal (RCC) ka filluar zyrtarisht në Sofje, më 27 shkurt 2008, si pasardhës i Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore. RCC-ja përqendrohet në promovimin dhe rritjen e bashkëpunimit rajonal në Evropën Juglindore (EJL) dhe mbështet integrimin evropian dhe euroatlantik të vendeve aspiruese. RCC-ja ofron kapacitetet operative dhe punon nën drejtimin politik të SEECP-it.

Në përputhje me statutin e saj të udhëhequr nga parimi gjithëpërfshirës, detyrat kryesore të RCC-së janë: të përfaqësojë rajonin, të ndihmojë SEECP-in, të monitorojë veprimtaritë rajonale, të ushtrojë lidhësinë në bashkëpunimin rajonal dhe të sigurojë një perspektivë rajonale në ndihmën e donatorëve - posaçërisht Instrumenti i Asistencës për Paraanëtarësim i BE-së - IPA. RCC-ja funksionon si pikë kryesore për bashkëpunim rajonal në EJL dhe roli i saj kyç është të gjenerojë dhe të bashkërendojë projektet zhvillimore të një karakteri më të gjerë rajonal, të përfitojë nga secili pjesëmarrës individualisht dhe të krijojë një klimë të përshtatshme politike të favorshme për zbatimin e tyre.⁷

⁶ Të gjitha informatat mbi RCC-në janë marrë nga faqja e internetit: <http://www.rcc.int>

⁷ <http://www.rcc.int/pages/6/2/overview>

Puna e RCC-së përqendrohet në gjashtë fusha parësore: 1) zhvillim ekonomik dhe social, 2) energji dhe infrastrukturë, 3) drejtësi dhe punë të brendshme, 4) bashkëpunim në fushën e sigurisë, 5) ndërtim të kapitalit njerëzor, dhe 6) bashkëpunim parlamentar si një çështje horizontale. RCC-ja në këto fusha punon ngushtë me të gjithë aktorët e rëndësishëm, siç janë: qeveritë, organizatat ndërkombëtare, institucionet ndërkombëtare financiare, shoqërinë civile dhe sektorin privat.

Statuti⁸ i RCC-së është në themel të veprimeve të saj. Sipas tij, bordi i RCC-së ofron udhëheqje operative dhe mbikëqyrje të organizatës. Bordi i RCC-së përbëhet nga pjesëmarrësit e RCC-së, të cilët kontribuojnë në buxhetin e sekretariatit të RCC-së, si dhe nga një anëtar i përfaqësuesit të lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë dhe një përfaqësues të Komisionit Evropian nga BE-ja.⁹

Buxheti vjetor i sekretariatit të RCC-së është afro 3 milionë euro, 40% e të cilit janë kontribut i rajonit të Evropës Juglindore, 30% kontribut i Komisionit Evropian dhe 30% nga pjesëmarrësit e tjerë të RCC-së. Sekretariati i RCC-së me seli në Sarajevë, Bosnjë-Hercegovinë, udhëhiqet nga sekretari i përgjithshëm, dhe ka po ashtu një zyrë ndërlidhëse në Bruksel.¹⁰

⁸ Rcc.int

⁹ Ibid v

¹⁰ Aktualisht sekretar i përgjithshëm i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal është Goran Svilanović.

2.3 Task forcat dhe nismat rajonale

Task forcat dhe nismat rajonale përbëjnë nivelin e tretë të bashkëpunimit rajonal dhe janë të shpërndara përgjatë rajonit dhe me ekspertizë në sektorë të ndryshëm. Shumica nga task forcat dhe nismat rajonale datojnë nga koha e Paktit të Stabilitetit dhe ende janë aktive dhe kanë mjetet e tyre për gjenerimin e fondeve, si dhe për kanalizimin e projekteve dhe të programeve. Të gjitha nismat rajonale, përfshirë task forcat, luajnë një rol në zhvillimin e mëtejshëm të strategjisë së RCC-së për EJK 2020.¹¹ Ato janë pjesë e strukturës së zbatimit të RCC-së qoftë përmes ofrimit të një mjedisi më të mirë ekonomik, social dhe politik në përgjithësi, ose përmes zhvillimit të qëllimeve dhe objektivave konkrete sektoriale, treguesve dhe politikave në nivel rajonal, duke pasqyruar prioritetet kombëtare të vendeve të EJK-së, të cilat aspirojnë objektivin themelor të Evropës 2020 – konkurrencën dhe rritjen ekonomike.¹²

¹¹ <http://www.rcc.int/pages/24/33/rcc-and-regional-initiatives-and-task-forces-in-south-east-europe>

¹² Ibid ix

Fusha e zhvillimit ekonomik dhe social



Kapitulli III

Fusha e zhvillimit ekonomik dhe social

3.1 Komisioni për Investime i Evropës Juglindore (SEEIC)¹³ - Sarajevë

Objektivi/Misioni - Komisioni për Investime i Evropës Juglindore (SEEIC) është themeluar në vitin 2007 nga vendet e EJT-së. Në të kaluarën SEEIC-ja ka operuar nën patronazhin e Kompartit të Investimeve për Evropën Juglindore të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD). SEEIC-ja ka synuar krijimin e një organi të nivelit të lartë për vendimmarrje dhe bashkërendim me qëllim dhe mandat për të nisur dhe për të mbështetur reformimin dhe zbatimin e politikave, të cilat nxisin investimet e huaja dhe vendore në rajonin e Evropës Juglindore.

Në mënyrë që të lejojë ekonominë e EJT-së që drejtpërdrejt të menaxhojnë dialogun rajonal dhe të bashkërendojnë përpjekjet që lidhen me reformimin e investimeve, në takimin e pestë të SEEIC-së, në muajin nëntor 2009, është nënshkruar kalimi i menaxhimit të SEEIC-së nga OECD-ja në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal (RCC). Bartja zyrtare e përgjegjësisë mbi veprimtarinë e SEEIC-së ka ndodhur në konferencën ministrore: Ndërtimi i vizionit 2020 për

¹³ Të gjitha informatat mbi SEEIC-në janë marrë nga faqja e internetit:
<http://www.seeic.rcc.int>

Evropën Juglindore në nëntor 2011, kur SEEIC-ja u autorizua të angazhohet në ndërtimin e vizionit të EJL-së 2020 dhe ta vendosë atë në pronësi rajonale.

SEEIC-ja aktualisht ka 3 objektiva kryesore: hartimin e Strate-gjisë së Evropës Juglindore 2020 (së bashku me vendet e EJL-së), bazuar në 5 shtylla të zhvillimit: 1) i integruar, 2) i zgjuar (smart), 3) i qëndrueshëm dhe 4) zhvillim gjithëpërfshirës i përforcuar 5) përmes qeverisjes për zhvillim, si dhe sundimit të ligjit. Përveç kësaj, nën ombrellën e RCC-së, SEEIC-ja është duke përqendruar përpjekjet e saj në intensifikimin e bashkëpunimit rajonal, sa u përket reformimit të investimeve dhe tregtisë, rritjes së zinxhirit të vlerës rajonale dhe përmirësimit të mjedisit afarist dhe investues në rajon.

Anëtarësia – SEEIC-ja aktualisht bashkëkryesohet nga Qeveria e Bosnjë-Hercegovinës (Ministria për Marrëdhënie Ekonomike dhe Tregti të Jashtme) dhe nga Sekretariati i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, dhe përbëhet nga zyrtarë të lartë në nivel të zëvendësministrit apo sekretarit të shtetit nga ministritë përkatëse të vendeve të Evropës Juglindore, konkretisht, Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Kosova, Moldavia, Mali i Zi, Rumania, Serbia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë. Komiteti mban dy takime në vit në Sarajevë. Komisioni gjithashtu mbledhet në formatin ministror një herë në vit në kryeqytetin e anëtarit të SEEIC-së, i cili është bashkëkryesues SEEIC.

Struktura




Tabela 1: Struktura dhe veprimtaria aktuale të SEEIC¹⁴

Financimi-Ky projekt financohet nga Komisioni Evropian.

Sekretariati i RCC-së - Projekt i Komisionit për Investime në Evropën Juglindore (SEEIC)

Dragana Đurica

Udhëheqëse e projektit

Sekretariati i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal

Trg BiH 1/V, 71000 Sarajevë

Bosnjë-Hercegovinë

Tel. + 387 33 561 717

Faks. + 387 33 561 701

E-mail: dragana.djurica@rcc.int

¹⁴ <http://www.seeic.rcc.int/pages/2/structure>

3.2 Marrëveshja për Tregti të Lirë e Evropës Qendrore - CEFTA 2006¹⁵, Bruksel

Objektivi/Misioni - CEFTA 2006 është një marrëveshje për ndryshim dhe për anëtarësim në marrëveshjen paraprake për tregti të lirë të Evropës. Ajo është përgatitur në këtë mënyrë për të lejuar ndryshimin e marrëveshjes dhe njëkohësisht zgjerimin e anëtarësisë së saj. Ajo është negociuar nga palët prej prillit të vitit 2006 deri në dhjetor të vitit 2006, nën patronazhin e Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore dhe me mbështetjen e Komisionit Evropian. Marrëveshja është në përputhje të plotë me detyrimet e palëve ndaj Bashkimit Evropian dhe, aty ku është e nevojshme, Organizatës Botërore të Tregtisë.

Anëtarësia - Palët nënshkruese të marrëveshjes së zgjeruar dhe të ndryshuar janë: Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Serbia dhe Kosova, e përfaqësuar nga Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Bullgaria dhe Rumania u larguan nga marrëveshja në janar të vitit 2007, me anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Sipas nenit 51 të CEFTA-s 2006, në rast të anëtarësimit në Bashkimin Evropian të ndonjërit nga shtetet anëtare të marrëveshjes CEFTA, ai shtet do të tërhiqet nga kjo marrëveshje më së voni një ditë para anëtarësimit. Marrëveshja përcakton ato fusha ku mund të

¹⁵ Të gjitha informatat mbi CEFTA-n janë marrë nga faqja e internetit: <http://www.cefta.int/>

marrë vendime Komisioni i Përbashkët dhe ku mund të lëshohen rekomandimet.

Struktura - Palët e CEFTA-s kanë krijuar një numër të strukturave për të menaxhuar dhe mbështetur zbatimin e marrëveshjes. Disa nga to, siç është Komisioni i Përbashkët, janë themeluar në bazë të vetë marrëveshjes, të tjerat janë krijuar më shumë përmes vendimeve të Komisionit të Përbashkët dhe disa funksione të tjera më shumë në baza ad-hoc. Organet zyrtare të CEFTA-s përfshijnë:

Komisioni i përbashkët, i cili kryesohet nga njëra ndër palët në baza rotative
Nënkomisioni për çështje bujqësore, sanitare dhe fitosanitare
Nënkomisioni për doganë dhe rregulla të origjinës
Nënkomisioni për barrierat teknike në tregti dhe për barrierat jotarifore
Grupi punues për barrierat teknike në tregti
Grupi punues mbi tregtinë në shërbime
Grupi punues për menaxhimin e riskut doganor
Sekretariati i CEFTA-s

Palët e CEFTA-s gjithashtu mbajnë takime të rregullta me zëvendësministrat përgjegjës për tregti për të siguruar përparim në çështje të ndryshme dhe, herë pas here, samitet e zëvendësministrave organizohen për të nxjerrë në pah arritjet e

veçanta dhe për të përsëritur përkushtimin për liberalizimin e tregtisë dhe promovimin e investimeve.

Sekretariati i CEFTA-s
Ndërtesa EFTA, 12-16 Rue Joseph II,
B-1000, Bruksel
Tel +32 2 229 10 11
Fax +32 2 229 10 19
Email: cefta@cefta.int

3.3 Rrjeti Shëndetësor për EJL (SEEHN)¹⁶ – Shkup

Objektivi/Misioni - SEEHN është një forum politik dhe institucional i krijuar nga qeveritë e: Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Bullgarisë, Kroacisë, Malit të Zi, Moldavisë, Rumanisë, Serbisë dhe Maqedonisë, për të promovuar paqen, pajtimin dhe shëndetin në rajon. Në vitin 2011, Izraeli u bë anëtar i 10-të i këtij rrjeti. Organizata Botërore e Shëndetësisë/Evropë jep mbështetje teknike për projektet e ndryshme shëndetësore të SEEHN-it, pas përkrahjes së ofruar sekretariatit të saj së bashku me Këshillin e Evropës prej vitit 2001 deri në vitin 2009. Më 1 janar 2010, nën patronazhin e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC) dhe të

¹⁶ Të gjitha informatat mbi SEEHN janë marrë nga faqja e internetit <http://seehnsec.blogspot.com/>
<http://www.euro.who.int/en/what-we-do/health-topics/Health-systems/public-health-services/south-eastern-europe-health-network-seehn>

procesit për bashkëpunim rajonal në EJL, SEEHN mori pronësinë e bashkëpunimit rajonal për shëndetësi dhe zhvillim. Qëllimi kryesor i RCC-së është të sigurojë leadership, të mbajë pronësinë në vendet anëtare dhe të sigurojë veprimin e bashkërenduar për zhvillimin e shëndetit të nisur me Zotimin e Dubrovnikut (2001), dhe të vazhduar përmes Zotimit të Shkupit (2005) dhe Memorandumit të Mirëkuptimit (2008).

Anëtarësia - Rrjeti Shëndetësor për Evropën Juglindore mbështetet nga një sekretariat me seli në Shkup, dhe anëtarë të tij janë: Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Izraeli, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi dhe Serbia.

RCC-ja dhe SEEHN-i kanë nënshkruar një memorandum të mirëkuptimit për bashkëpunimin e tyre në të ardhmen. RCC-ja do të vazhdojë ofrimin e mbështetjes politike dhe të përfaqësimit të Rrjetit Shëndetësor për EJL-në dhe të veprimtarive të saj rajonale dhe do të ndihmojë atë në bashkërendimin e veprimtarive të saj me nismat e tjera të rëndësishme të bashkëpunimit rajonal në fushën e shëndetit publik. SEEHN-i gjithashtu ka pranuar mbështetje të vazhdueshme politike, teknike dhe financiare nga 10 vendet partnere (Belgjika, Franca, Greqia, Hungaria, Italia, Norvegjia, Sllovenia, Suedia, Zvicra dhe Mbretëria e Bashkuar) dhe nga pesë organizata (Këshilli i Evropës, Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës, OBSH- Zyra Rajonale për Evropë dhe Sekretariati i Paktit të Stabilitetit).

Struktura - Presidenca e SEEHN-it kryesohet nga Moldavia (janar-qershor 2013).

Financimi - Vendet anëtare, të cilat marrin pjesë në SEEHN, kontribuojnë financiarisht në buxhetin e sekretariatit të SEEHN-së në baza vjetore me një shumë që llogaritet në bazë të metodologjisë së zhvilluar për kontribute në RCC.

Sekretariati i SEEHN-it në Shkup është i vendosur në objektet e Ministrisë së Shëndetësisë së Maqedonisë.

3.4 Grupi i Përhershëm Punues për Zhvillim Rural Rajonal në Evropën Juglindore (SEE RDSWG)¹⁷ - Shkup

Objektivi/Misioni - RDSWG-ja është një organizatë ndërqeveritare për zhvillim rural rajonal në Evropën Juglindore, e cila ka për qëllim të fuqizojë dhe të promovojë bujqësinë e qëndrueshme dhe zhvillimin rural, nëpërmjet rrjetëzimit dhe bashkëpunimit të përhershëm të të gjithë aktorëve të bujqësisë dhe zhvillimit rural në rajonin e Evropës Juglindore. Ajo u themelua në bazë të konkluzioneve të Forumit për politika bujqësore në vitin 2004 dhe Forumit për politika bujqësore në vitin 2005, të mbajtur në Leipzig. RCC-ja dhe RRDSWG-ja nënshkruan një memorandum të mirëkuptimit në vitin 2009 në fushën e bujqësisë, të zhvillimit

¹⁷ Të gjitha informatat mbi SEE RDSWG janë marrë nga faqja e internetit <http://www.seerural.org/>

ekonomik dhe rural, të mbrojtjes së mjedisit dhe sigurisë së ushqimit.

Misioni i Grupit të Përhershëm Punues për Zhvillim Rural Rajonal në Evropën Juglindore (SWG) është që të rrisë bashkëpunimin horizontal midis ministrive të bujqësisë dhe organizatave ndërkombëtare për bashkimin e punës në drejtim të zhvillimit të rajonit rural të Evropës Juglindore, në mënyrë që të zbatojnë politika gjithëpërfshirëse dhe të hartojnë nisma të bazuara në rezultate. SWG-ja shërben për të siguruar bashkëpunim të afërt, të hapur, aktiv, konstruktiv dhe të përhershëm midis anëtarëve në proceset e vazhdueshme të integritit në BE, për të stimuluar dhe organizuar nismat dhe veprimtaritë që lidhen me zhvillimin rural në nivel kombëtar, rajonal dhe global, për të dhënë mbështetje të drejtpërdrejtë për kryerjen e studimeve, vlerësimeve dhe hulumtimeve në zhvillimin rural dhe për të ndihmuar në planifikimin dhe programimin strategjik për zhvillimin rural. SWG-ja është përgjegjëse për iniciimin, përgatitjen, bashkërendimin dhe zbatimin e projekteve të zhvillimit rural në EJT. Ajo gjithashtu mbështet qeveritë e vendeve anëtare, institucionet akademike, shoqatat dhe organizatat, në ndërtimin e kapaciteteve dhe rrjetëzimit në Evropën Juglindore.

Anëtarësia - Anëtarë janë: Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Kosova.

Struktura - Sekretari i përgjithshëm emërohet nga Asambleja me një mandat 3-vjeçar me mundësi të vazhdimit. Përgjegjësitë e

sekretariatit përfshijnë: menaxhimin, bashkërenditjen dhe përfaqësimin e përgjithshëm të SWG-së dhe organeve të saj. Sekretari i përgjithshëm është përgjegjës për raportim në baza vjetore në kuvend për të gjitha veprimtaritë e kryera, duke përfshirë raportimin financiar për vitin paraprak. Sekretariati është një organ operativ, administrativ, bashkërendues dhe organizativ i SWG-së me seli në Shkup.

Financimi: Kosova kontribuon me 20.000 euro në vit për anëtarësi në SEE RDSWG.

SWG Zyra Qendrore/Sekretariati
rr. Albert Svajcer br. 6, P.O Box 659
1000 Shkup
Maqedoni
Tel: + 389 2 3 217 708
Faks: + 389 2 3 217 244
swgsecretariat@swg-seerural.org

Transporti dhe infrastruktura

Kapitulli IV

Transporti dhe infrastruktura

4.1 Traktati i Komunitetit të Energjisë (TKE)¹⁸ - Sekretariati në Vjenë

Objektivi/Misioni - Komuniteti i Energjisë është një organizatë ndërkombëtare që merret me politikat energjetike. Organizata është themeluar në Athinë, Greqi, në tetor të vitit 2005, përmes një traktati të së drejtës ndërkombëtare. Traktati hyri në fuqi në korrik të vitit 2006. Palë të Traktatit që themelojnë Komunitetin e Energjisë janë Bashkimi Evropian, në njërin anë, dhe nëntë palë kontraktuese nga Evropa Juglindore dhe rajoni i Detit të Zi. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë e ka selinë në Vjenë, Austri.

Anëtarësia - Palë të Traktatit janë BE-ja, në njërin anë, dhe Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Serbia, Maqedonia, Mali i Zi, Moldavia, Kosova, Ukraina, në anën tjetër. Ndërsa anëtarët themelues të Traktatit, me të cilin u themelua Komuniteti i Energjisë në vitin 2005, Bullgaria dhe Rumania, iu bashkuan BE-së në vitin 2007. Në bazë të nenit 99 të Traktatit, statusi i tyre ka ndryshuar në palë pjesëmarrëse. Rasti i njëjtë ishte edhe me Kroacinë prej 1 korrikut 2013.

¹⁸ Të gjitha informatat mbi TKE-në janë marrë nga faqja e internetit e TKE-së http://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/SECRETARIAT

Pasi morën statusin e vëzhguesit, Moldavia dhe Ukraina zyrtarisht shprehën interesimin e tyre për anëtarësim të plotë. I mandatuar nga Këshilli ministror, në fund të vitit 2008, Komisioni Evropian mbajti raundin e parë të bisedimeve zyrtare me Moldavinë dhe Ukrainën. Ndërsa Moldavia u bë anëtare e plotë që nga 1 maji i vitit 2010, Ukraina zyrtarisht ka aderuar në Komunitetin e Energjisë më 1 shkurt të vitit 2011.

Armenia, Gjeorgjia, Norvegjia dhe Turqia marrin pjesë si vëzhguese. Gjeorgjia aktualisht është në proces të anëtarësimit në Komunitetin e Energjisë si një anëtare e plotë. Pjesëmarrës: Bashkimi Evropian, i përfaqësuar nga Komisioni Evropian si një zëvendëspresident i përhershëm i organizatës. Ai kryeson shumicën e takimeve institucionale. Në të njëjtën kohë, çdo shtet anëtar i Bashkimit Evropian mund të marrë statusin e pjesëmarrësit. Si anëtar i Bashkimit Evropian, pjesëmarrësit kanë në vetvete një detyrim për t'u pajtuar me *acquis communautaire*. Një vend me status të pjesëmarrësit ka të drejtë të marrë pjesë në të gjitha takimet institucionale të Komunitetit të Energjisë. Aktualisht 16 shtete anëtare të Bashkimit Evropian mbajnë statusin e pjesëmarrësve.

Struktura - Një kuadër i fuqishëm institucional e mbështet procesin. Ndërsa Këshilli ministror mbledhet një herë në vit, takimet e grupit të përhershëm të nivelit të lartë mbahen çdo tre muaj. Është ministri ose, si alternativë, një zyrtar i lartë nga Ministria për Energji ose e Financave ai që përfaqëson palën në dy organe ekzekutive. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë i

mbledh rreth tryezës rregullatorët kombëtarë nga rajoni. Puna e tij është e organizuar në grupe punuese për energjinë elektrike, gazin natyror dhe mbrojtjen e konsumatorëve. Katër forume këshillëdhënëse në fushën e energjisë elektrike, të gazit, çështjeve sociale dhe naftës, të konceptuara si platforma për diskutim, e plotësojnë procesin.

Me seli në Vjenë, Sekretariati është institucioni i vetëm i cili vepron në mënyrë të përhershme. Ai ka aktualisht një personel prej 22 anëtarëve, që përfaqësojnë 13 kombësi. Ai ndihmon, monitoron dhe fuqizon procesin e zbatimit. Sa u përket veprimtarive të politikës energjetike, ai u ofron përkrahje administrative institucioneve të tjera të Komunitetit të Energjisë dhe organizon rreth 40 ngjarje në vit. Që nga 1 janari i vitit 2010, z. Janez Kopaç vepron si drejtor i Sekretariatit.

Veprimtaritë e Komunitetit të Energjisë financohen nga kontributet e palëve të Traktatit, i cili themelon Komunitetin e Energjisë sipas tabelës së kontributeve të palëve e vendosur në shtojcën IV të Traktatit.¹⁹ Sipas nenit 73 të Traktatit, "niveli i kontributeve mund të rishikohet çdo pesë vjet, me kërkesë të cilësdo palë, me një akt procedural të Këshillit ministror." Një burim tjetër i të ardhurave të Komunitetit të Energjisë vjen nga Republika e Austrisë si vend mikpritës i Sekretariatit. Që prej themelimit të tij në vitin 2005, Sekretariati ka marrë rregullisht

¹⁹ http://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/ENERGY_COMMUNITY/Legal/Treaty#AN_NEXIV

kontributet për shpenzimet e qirasë. Në vitin 2013, Austria për qira ka kontribuar me 160.000 euro - që përfaqëson 5% të buxhetit të përgjithshëm të vitit 2012.²⁰

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë Am Hof 4

1010 Vjenë, AUSTRI

tel:+ 431 535 2222

faks:+ 431 535 2222 11

heli.lesjak@energy-community.org

4.2 Observatori i Transportit për Evropën Juglindore (SEETO)²¹ - Beograd

Objektivi/Misioni – Traktati i Komunitetit të Transportit aktualisht nën bisedime me palët nga Evropa Juglindore është projektuar për të integruar në tërësi rajonin në tregun evropian të transportit dhe mbi bazën e *acquis* përkatëse të Bashkimit Evropian, duke përfshirë integrimin në fushat e standardeve teknike, ndërveprimit, sigurisë, menaxhimit të trafikut, politikat sociale, prokurimit publik dhe mjedisit për të gjitha llojet e transportit, duke përjashtuar transportin ajror. Ai plotëson politikën e

²⁰ http://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/SECRETARIAT/Budget

²¹ Të gjitha informatat mbi SEETO-n janë marrë nga faqja e internetit www.seetoint.org

zgjërimit të BE-së. Traktati ndërtohet mbi: (a) memorandumit e mirëkuptimit për zhvillimin e rrjetit rajonal të transportit në Evropën Juglindore të 11 qershorit të vitit 2004, (b) shtojcën e memorandumit të mirëkuptimit për Zonën e Transportit Hekurudhor të Evropës Juglindore të 4 dhjetorit të vitit 2007, si dhe, aty ku është relevante (c) traktatet ekzistuese për Komunitetin e Energjisë dhe Zonën e Përbashkët Ajrore.

Anëtarësia - SEETO është nismë rajonale, e cila përbëhet prej 7 anëtarëve: Shqipërisë, Bosnjë- Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Serbisë dhe Kosovës.

Struktura - Në Memorandumit e Mirëkuptimit, rrjeti i institucioneve në vazhdim është paraparë që të orientojë dhe të nxisë procesin e zhvillimit në Rrjetin gjithëpërfshirës së SEETO-s:

Takimi vjetor i ministrave (AMM) është forumi më i lartë politik, ku është konfirmuar progresi i Rrjetit Gjithëpërfshirës të SEETO-s në lidhje me MeM, është pranuar plani shumëvjeçarë i Rrjetit Gjithëpërfshirës të SEETO-s dhe është rënë dakord për strategjitë e ardhshme. Në atë takim marrin pjesë ministrat e transportit të secilit pjesëmarrës rajonal dhe nga Komisioni Evropian.

Komiteti drejtues siguron bashkërendimin e punës së përbashkët të nënshkruesve të memorandumit të mirëkuptimit. Ai përbëhet nga një përfaqësues dhe një zëvendësperfaqësues nga secili pjesëmarrës në nivel të zëvendësministrave apo në nivel të nëpunësve të lartë civilë. Ai bashkëkryesohet nga një kryesues nga rajoni i Evropës Juglindore dhe nga Komisioni Evropian. Komiteti

drejtues është struktura kryesore përgjegjëse për udhëheqjen e veprimtarive të SEETO-s dhe bashkërendimin e planifikimit të infrastrukturës së transportit, si dhe për promo-vimin dhe kryerjen e reformave kombëtare në përputhje me qasjen e dakorduar të BE-së dhe asaj rajonale.

Sekretariati i SEETO-s siguron mbështetje për komitetin drejtues dhe lehtëson bashkërendimin e pjesëmarrësve rajonalë, Komisionit Evropian dhe institucioneve ndërkombëtare financiare. Ai gjithashtu bashkëpunon me aktorë të tjerë të përfshirë drejtpërdrejt në zbatimin e memorandumit të mirëkuptimit, siç janë grupet punuese dhe bashkërenduesit kombëtarë, dhe me institucionet financiare ndërkombëtare, organet rajonale dhe donatorët aktivë në rajon. Sekretariati i SEETO-s analizon performancën e rrjetit gjithëpërfshirës së SEETO-s, duke regjistruar përparimin e bërë në arritjen e dispozitave të memorandumit të mirëkuptimit, është përgjegjës për prodhimin dhe rifreskimin e planit shumëvjeçar të rrjetit gjithëpërfshirës të SEETO-s dhe ndihmon komitetin drejtues në promovimin e reformimit të politikave dhe harmonizimit të sektorit të transportit.

Koordinatorët nacionalë caktohen nga çdo pjesëmarrës rajonal me rolin për të vepruar si mbështetje teknike e bashkëpunimit të SEETO-s dhe si ndërmjetës midis pjesëmarrësve përkatës rajonalë dhe Sekretariatit të SEETO-s.

Grupet punuese janë krijuar nga ekspertë të deleguar nga autoritetet e respektuara kombëtare; ato përfshijnë përfaqësuesit e çdo pjesëmarrësi rajonal dhe të Komisionit Evropian (DG MOVE) dhe mbështesin komitetin drejtues. Grupi punues për Hekurudhat dhe Ndërmodalitetet është themeluar në vitin 2006, ndërsa grupi punues për siguri në rrugë është themeluar nga komiteti drejtues në vitin 2009. Përveç shkëmbimit të praktikave të mira, grupet punuese kontribuojnë në promovimin e harmonizimit në sektorin e transportit dhe monitorojnë zbatimin e masave të buta.

SIV III

Omladinskih Brigada 1

5th Floor office 555

P.Fah (P.O.Box) 14

11198 Beograd, Serbi

Tel.: +381/11-3131799, 3131805

Fax: +381/11-3131800

Email: office@seetoint.org

4.3 Hapësira e Përbashkët Evropiane e Aviacionit (ECAA)²² - Bruksel

Objektivi/Misioni - Në sektorin e aviacionit, në qershor të vitit 2006, partnerët nga Evropa Juglindore kanë ndërmarrë një hap të rëndësishëm drejt integritit të EJT-së në tregun e brendshëm të aviacionit të BE-së duke nënshkruar një marrëveshje për krijimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit. Marrëveshja është e bazuar mbi hapjen graduale të tregut, mbi lirinë e themelimit dhe jodiskriminimit, të kushteve të barabarta të konkurrencës dhe rregullave të përbashkëta në të gjitha hapësirat e aviacionit civil (rregullimin ekonomik, sigurinë, menaxhimin e trafikut ajror, mbrojtjen mjedisore dhe sociale, konkurrencën, ndihmën e shtetit, etj.). Ajo angazhon partnerët e Evropës Juglindore për të zbatuar legjislacionin e BE-së në trafikun ajror nëpër periudha transitore me qëllim të integritit të tyre të plotë në tregun e brendshëm të transportit ajror të BE-së. Në këtë drejtim është arritur një përparim i konsiderueshëm nga të gjithë partnerët e ECAA-s, mirëpo ende janë të nevojshme përpjekje të mëtejshme për të zbatuar acquis.

Anëtarësia - Palët kontraktuese të marrëveshjes ECAA janë BE-ja dhe shtetet anëtare të saj, Islanda, Norvegjia dhe partnerët nga

²² Të gjitha informatat mbi ECAA-në janë marrë nga faqja e internetit http://ec.europa.eu/transport/modes/air/international_aviation/country_index/ecaa_en.htm

Evropa Juglindore (Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi dhe Kosova).

Drejtoria e përgjithshme për mobilitet dhe transport

Komisioni Evropian

DG Mobility and Transport

B – 1049 Bruksel

Zyrat:

Rue J.-A. Demot, 24-28

B – 1040 Bruksel

E-mail: move-infos@ec.europa.eu

Drejtësia dhe punët e brendshme

Kapitulli V

Drejtësia dhe punët e brendshme

5.1 Nisma Rajonale për Migracionin, Refugjatët dhe Azilin (MARRI)²³ - Shkup

Objektivi/Misioni - Nisma Rajonale për Migracionin, Refugjatët dhe Azilin (MARRI) merret me çështjet e menaxhimit të migracionit në Ballkanin Perëndimor duke promovuar bashkëpunim më të ngushtë rajonal dhe një qasje gjithëpërfshirëse, të integruar dhe koherente të çështjeve të migracionit, azilit, menaxhimit të kufijve, politikës së vizave dhe bashkëpunimit konsullor, zgjidhjes dhe kthimit të refugjatëve në mënyrë që të plotësojnë standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Prioriteti kryesor i MARRI-t është rritja e bashkëpunimit rajonal në fushat e saj të veprimtarive midis vendeve në rajon, si një pjesë vitale e procesit të integrimit në BE dhe në përputhje me Agjendën e Selanikut për Ballkanin Perëndimor. Ideja e përgjithshme ishte që vendet e rajonit të marrin në pronësi bashkëpunimin rajonal. Shtetet anëtare të MARRI-t kanë shprehur gatishmërinë e tyre për përparimin e vazhdueshëm në fushat e MARRI-t, siç tregohet nëpërmjet kalimit të MARRI-t nën pronësinë rajonale.

²³ Të gjitha informatat mbi MARRI-n janë marrë nga faqja e internetit www.marri-rc.org

Anëtarësia - Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia.

Struktura - MARRI drejtohet nga gjashtë shtetet anëtare të saj (Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia), të cilat takohen dy herë në vit në forumin rajonal të MARRI-t. Presidenca e MARRI-t kryesohet nga të gjitha shtetet anëtare në mënyrë rotative.

Forumet dhe takimet e komitetit – Afatet e rregullta për mbajtjen e forumeve të MARRI-t janë dy herë në vit: në prill dhe në nëntor. Takimet e komitetit deri më tani u kanë paraprirë forumeve dhe janë organizuar një apo dy ditë më herët në të njëjtin vend.

Takimet e miqve të MARRI-t – Takimet e shkurtra diplomatike janë aktivitete që mbahen në fillim të vitit me qëllim të prezantimit të planit vjetor të veprimtarive të MARRI-t, organizatave ndërkombëtare dhe përfaqësuesve të korit diplomatik.

Krijimi i rrjetit të MARRI-t – Në përputhje me Strategjinë dhe Planin e Veprimit të MARRI-t, përveç tre rrjeteve tashmë të krijuar (azili, policia kufitare në aeroporte dhe trafikimi me qenie njerëzore), deri në mars të vitit 2013 është paraparë krijimi i rrjetit të ekspertëve dhe zyrtarëve kontaktues për bashkëpunim në çështjet e migracionit të ligjshëm.

Kontributi vjetor i shteteve anëtare nuk është i fiksuar por ndryshon, ndërsa donatorët financojnë veprimtaritë e lidhura me projektet.

Qendra rajonale e MARRI-t

**Adresa: ndërtesa e MTV-së, kati i 8-të, bulevardi “Goce Delčev”,
p.n.**

P.O. Box 447, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë

Tel: + 389 (2) 32 35 700

Fax: + 389 (2) 32 35 711

Email: info@marri-rc.org.mk

Web: www.marri-rc.org

5.2 Nisma Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI)²⁴ – Sarajevë

Objektivi/Misioni – Aktualisht e vetmja qendër rajonale e përkushtuar për të frenuar korrupsionin në Evropën Juglindore (EJL), Sekretariati i RAI-t paraqet një demonstrim konkret dhe të dukshëm të përkushtimit të shteteve anëtare në luftën e vazhdueshme, të përbashkët dhe të bashkërenduar, kundër korrupsionit në rajon.

Sekretariati është organ ekzekutiv i nismës dhe ka për detyrë t’i sigurojë mbështetje të përgjithshme administrative grupit drejtues të RAI-t. Ai i jep shtysë luftës kundër korrupsionit në Evropën Juglindore duke u ndërtuar mbi bazën e veprimeve ekzistuese, nëpërmjet bashkërendimit më të mirë dhe duke u mbështetur në

²⁴ Të gjitha informatat mbi RAI-n janë marrë nga faqja e internetit <http://www.rai-see.org>

angazhimin politik të nivelit të lartë. Qëllimi i tij i vazhdueshëm është që të ndihmojë dhe të mbështesë shtetet në Evropën Juglindore në miratimin e legjislacionit efikas, në krijimin e institucioneve efikase, në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe në zhvillimin e praktikave më të mira në shoqërinë civile për një luftë të përbashkët dhe të qëndrueshme kundër korrupsionit.

Anëtarësia - Aktualisht 9 shtete nga Evropa Juglindore i janë bashkuar RAI-t – Shqipëria, Bosnjë- Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Rumania dhe Serbia.

Struktura - Grupi drejtues (SG) është organ vendimmarrës i nismës, prandaj anëtarësimi në grupin drejtues është thelbësor për udhëheqjen dhe funksionimin e RAI-t. Anëtarësimi në grupin drejtues të nismës është fleksibil dhe në parim i hapur për çdo vend të interesuar, organizatë ndërkombëtare ose institucion ndërkombëtar financiar, me kusht që ata të jenë të përkushtuar që të japin kontributin e tyre në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në Evropën Juglindore. Ekzistojnë dy nivele të anëtarësimit në grupin drejtues:

Grupi i parë përbëhet nga anëtarët kyç, të cilët kanë nënshkruar MeM-in, duke e angazhuar veten për të siguruar qëndrueshmëri financiare të Sekretariatit të nismës, duke ofruar një kontribut vjetor në vlerë prej **24. 000 eurove**. Aty gjenden shtetet tashmë të përfshira në procesin e bashkëpunimit në Evropën Juglindore (SEECp), si dhe organizatat ndërkombëtare apo institucionet ndërkombëtare financiare të gatshme që t'i bashkohen nismës duke depozituar instrumentin e pranimit nën kushtet e njëjta sikurse ato të anëtarëve fillestarë. Njoftimi për anëtarësim duhet

t'i dërgohet Ministrisë së Drejtësisë së Kroacisë, e cila vepron si vend depozitues i MeM-it.

Grupi i dytë përfaqësohet nga anëtarët e asociuar – ato palë të cilat kontribuojnë në veprimtaritë specifike programore të nismës me së paku shumën minimale vjetore të kërkuar për anëtarët kyç, pa e nënshkruar MeM-in. Anëtarët kyç dhe anëtarët e asociuar marrin pjesë në mënyrë të barabartë në diskutimet e grupit drejtues në lidhje me çështjet programore.

Palët e tjera të interesuara (shtetet apo organizatat) që janë të përfshira në luftën kundër korrupsionit në Evropën Juglindore (EJL) ose që kontribuojnë në RAI më pak se shumën minimale vjetore e përcaktuar në MeM kanë të drejtë të jenë vëzhguese në takimet e grupit drejtues duke emëruar përfaqësuesit e tyre përkatës. Zbatuesit e projekteve janë vëzhgues gjithashtu. Aktualisht 9 shtete nga Evropa Juglindore i janë bashkuar RAI-t – Shqipëria, Bosnjë- Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Rumania dhe Serbia.

Zyra qendrore: Bistrik 5

Zyra ekzekutive: Mis Irbina 6

71000 Sarajevë

Bosnjë-Hercegovinë

E-mail: info@rai-see.org

Telephone: +387 33 258 990

Fax: +387 33 258 991

5.3 Qendra për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore (SELEC)²⁵ - Bukuresht

Objektivi/Misioni - Objektivi i SELEC-it, brenda kuadrit të bashkëpunimit midis autoriteteve kompetente, është të sigurojë mbështetje për shtetet anëtare dhe të forcojë bashkërendimin për të parandaluar dhe për të luftuar krimin, përfshirë këtu krimin e rëndë dhe të organizuar, kur këto krime përfshijnë ose duket se përfshijnë një element të veprimtarisë ndërkuftare. Konventa e re parashikon që SELEC-i: të bashkërendojë operacionet rajonale dhe të mbështesë hetimet dhe veprimtaritë e parandalimit të krimit të shteteve anëtare në rastet ndërku-ftare; t'ua sigurojë mundësinë shteteve anëtare për të shkëmbyer informacionin dhe inteligjencën e kriminalitetit dhe të ofrojë ndihmë operationale në mënyrë të shpejtë dhe në kohë; të mbledhë, të bashkojë, të analizojë, të përpunojë dhe të shpërndajë informacionin dhe inteligjencën kriminale; dhe të prodhojë analiza strategjike e të bëjë vlerësime të kërcënimeve që lidhen me objektivin e saj.

Të krijojë, të realizojë dhe të mirëmbajë një sistem të kompjuterizuar informacioni, që nënkupton edhe sigurimin e mbrojtjes të të dhënave personale. Përfitimi për shtetet anëtare, si dhe për partnerët e qendrës, do të jetë në aftësinë për të trajtuar operacionet dhe hetimet multinacionale të orientuara nga rezultati në rajonin e Evropës Juglindore me një investim minimal.

²⁵ Të gjitha informatat mbi SELEC-in janë marrë nga faqja e internetit <http://www.secicenter.org/>

SELEC-i aspron të vazhdojë të jetë depozituesi i praktikave të mira në zbatimin e ligjit dhe vetëdijesimin nëpërmjet takimeve dhe konferencave multinacionale, duke sjellë në një vend përfaqësuesit e shteteve anëtare, si dhe partnerët e saj. Më 7 tetor 2001, Qendra SECI u bë SELEC, ndërsa kapacitetet e saj operacionale dhe strategjike u mbajtën dhe u transferuan në SELEC-in e ri.

SELEC-i trashëgon suksesin e Qendrës SECI - 12 vjet të veprimtarisë operacionale, hetimeve të përbashkëta, takimeve, punëtore dhe analizave strategjike që mbulojnë fushat më të ndjeshme tejkuftare kriminale në rajonin e Evropës Juglindore. Gjatë gjithë kësaj periudhe, shkëmbimi intensiv i informacionit nëpërmjet zyrtarëve ndërlidhës dhe kanaleve të qendrës për komunikim kanë mbështetur në mënyrë të suksesshme përpjekjet e agjencive për zbatimin e ligjit në shtetet anëtare. Nga një perspektivë operacionale, SELEC-i i ri mirëmban fleksibilitetin dhe efikasitetin operacional, duke rritur kapacitetin e analizës me një sistem më të gjerë të informacionit dhe një nivel adekuat të mbrojtjes së të dhënave personale në përputhje me standardet e BE-së. Konventa e re ia siguron qendrës një personalitet juridik ndërkombëtar dhe gjithashtu përcakton dhe mbështet bashkëpunimin me organizatat e tjera kryesore ndërkombëtare të zbatimit të ligjit.

Anëtarësia - Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Hungaria, Moldavia, Mali i Zi, Rumania, Serbia dhe Turqia.

Struktura – SELEC-i udhëhiqet nga drejtori i përgjithshëm që vepron si nëpunës i lartë ekzekutiv dhe përfaqësues ligjor. Drejtori i përgjithshëm ndihmohet nga dy drejtorë, konkretisht nga drejtori

i operacioneve dhe drejtori për çështje të brendshme dhe ligjore. Këshilli është organi më i lartë vendimmarrës i SELEC-it dhe përbëhet nga përfaqësues të nivelit të lartë të emëruar nga çdo shtet anëtar. Çdo shtet anëtar ka një votë në procesin e vendimmarrjes. Këshilli do të ketë si kryesues dhe zëvendëskryesues të saj zyrtarë të nivelit të lartë nga autoritetet kompetente të shteteve anëtare, të zgjedhur për një mandat njëvjeçar me rotacion alfabetik midis shteteve anëtare. Rotacioni alfabetik do të fillojë me shkronjën e parë të alfabetit të gjuhës angleze për shtetet anëtare që mbajnë postin e kryesuesit dhe me renditje të kundërt për shtetet anëtare, të cilat mbajnë postin e zëvendëskryesuesit. Këshilli bën zgjedhjen e udhëheqjes së SELEC-it, në përputhje me kërkesat dhe kushtet e vendosura në Konventën e SELEC-it. Rrjeti i SELEC-it përbëhet nga zyrtarët ndërlidhës nga autoritetet policore dhe doganore të shteteve anëtare, i mbështetur nga 12 pika kryesore kombëtare të krijuara në çdo shtet anëtar. Përfaqësuesit e pikave kryesore kombëtare mbesin në kontakt të përhershëm me zyrtarët ndërlidhës në zyrat qendrore të SELEC-it dhe mbajnë marrëdhënie të afërta me autoritetet policore dhe doganore në vendin mikpritës. Pikat kryesore kombëtare sigurojnë rrjedhën e shpejtë të informacionit, duke mbledhur dhe duke shpërndarë kërkesat për informacion dhe përgjigjet për agjencitë e zbatimit të ligjit dhe për zyrtarët ndërlidhës të zyrave qendrore.

Adresa postare: Rumani, 050711 Bukuresht, Bulevardi Calea 13

Septembrie, nr. 1-5, Sektori 5

Tel: (+4021) 303.60.09

Fax (+4021) 303.60.77

Email: secretariat@selec.org

Bashkëpunimi për çështje të sigurisë

Kapitulli VI

Bashkëpunimi për çështje të sigurisë

6.1 Nisma për Përgatitje dhe Parandalim ndaj Katastrofave (DPPI)²⁶ - Sarajevë

Objektivi/Misioni - Në nëntor të vitit 2000, Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore ndërmori “Nismën për parandalim dhe përgatitje ndaj katastrofave” si një përpjekje për të kontribuar në zhvillimin e një strategjie rajonale të bashkuar për përgatitjen dhe parandalimin e katastrofave për shtetet e rajonit të Evropës Juglindore (në tekstin e mëtejshëm: EJL). Pas përfundimit të procesit të transicionit nga Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal në pronësi rajonale, të themeluar më 27 shkurt 2008, një fazë e re filloi për bashkëpunim ndërmjet shteteve në rajonin e EJL-it. Në cilësinë e krahut operacional të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECp), Këshilli për Bashkëpunim Rajonal me Sekretariatit e saj në Sarajevë mori përsipër bashkërendimin e nismave përkatëse dhe task forcave të trashëguara nga Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore.

²⁶ Të gjitha informatat mbi DPPI SEE janë marrë nga faqja e internetit <http://www.dppi.info/>

Sot, DPPI SEE është një shembull i shkëlqyer i pronësisë rajonale, me përfshirje të plotë të vendeve të rajonit, të cilat operojnë në ombrellën e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC) të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEEC). Memorandumi i mirëkuptimit mbi kornizën institucionale të DPPI SEE me të cilën krijohet DPPI SEE deri më tani është nënshkruar nga 11 shtete – Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia, Moldavia, Rumania, Serbia, Mali i Zi, Sllovenia dhe Turqia, si dhe është mbështetur nga donatorët dhe shtetet partnere, agjencitë dhe organizatat ndërkombëtare.

DPPI SEE është konceptuar si një veprimtari, e cila kërkon të ofrojë një kornizë për vendet e Evropës Juglindore për zhvillimin e programeve dhe të projekteve që çojnë në forcimin e kapaciteteve në parandalimin dhe reagimin ndaj katastrofave natyrore dhe të atyre të shkaktuara nga njeriu. Ajo gjithashtu sjell së bashku vendet donatore dhe organizatat ndërkombëtare e joqeveritare për të bashkërenduar veprimtaritë e vazhdueshme dhe për të identifikuar nevojat e paplotësuara në mënyrë që të përmirësojnë efikasitetin e sistemeve kombëtare për menaxhimin e katastrofave brenda kornizës së bashkëpunimit rajonal.

Memorandumi i Mirëkuptimit përcakton qëllimet dhe objektivat e kësaj nisme, strukturën qeverisëse dhe bashkërenduese, rolin dhe përgjegjësitë e bordit këshillëdhënës, të grupeve punuese, të partnerëve; ai përcakton rolin e sekretariatit, si dhe buxhetin dhe financimin. Në shtojcat e tij jepen termat e referencës për kryetarin e zyrës, bordin këshillëdhënës, udhëheqësin e sekretariatit

dhe ndihmësin administrativ/financiar. DPPI SEE është i dizajnuar për t'u shërbyer interesave të shteteve anëtare të saj dhe për këtë qëllim ajo synon të plotësojë nevojën për një bashkëpunim më të gjerë, në shumë nivele dhe shumëdimensional midis shteteve anëtare në secilën fazë të procesit të menaxhimit të rrezikut nga katastrofat në mënyrë që t'u mundësojë shteteve që në mënyrë më efektive të ballafaqohen me katastrofat dhe të sjellë Evropën Juglindore drejt një bashkëpunimi të plotë me mekanizmat e mbrojtjes civile të BE-së (CPM). Për më tepër, shumëllojshmëria e anëtarësisë brenda DPPI SEE (shtetet potenciale candidate, ato candidate dhe anëtare të BE-së) përfaqëson një "vlerë të shtuar" të bashkëpunimit gjithëpër-fshirës rajonal. Qëllimi kryesor i DPPI SEE është që të nxisë bashkëpunimin dhe bashkërendimin rajonal në përgatitjen dhe parandalimin e katastrofave për fatkeqësitë natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu në Evropën Juglindore, pa krijuar struktura apo shtresa burokratike.

Anëtarësia - Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Rumania, Sllovenia, Serbia, Turqia, Greqia e Hungaria.

Struktura - Bashkëpunimi afatgjatë rajonal në përgatitjen dhe parandalimin e katastrofave në Evropën Juglindore nuk është zhvilluar në mënyrë të mjaftueshme dhe ende ka nevojë që të arrihet një qasje e bashkuar/unifikuar rajonale për zvogëlimin e rrezikut nga katastrofat/fatkeqësitë (DRR). Nisma për përgatitjen dhe parandalim të katastrofave (DPPI) është tërësisht në pronësi rajonale, mirëpo sekretariati i saj ka mungesë të kapaciteteve të

nevojshme për të marrë përsipër një rol më të madh si një agjenci për zbatimin e projekteve me një ndikim më të gjerë mbi bashkëpunimin për zvogëlimin e rrezikut nga katastrofat në Evropën Juglindore. Memorandumit të Mirëkuptimit me të cilin themelohet DPPI i kalon afati në fund të vitit 2013. Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC) është anëtar i takimit rajonal të DPPI-së dhe kryetari i zyrës së DPPI (CiO) i raporton Këshillit për Bashkëpunim Rajonal.

Sekretariati i DPPI SEE

Tel/fax: + 387 33 212 340 | +387 33 223 175

secretariat@dppi.info

6.2 Konventa për Bashkëpunim Policor për Evropën Juglindore (PCCSEE)²⁷ – Lubjanë

Objektivi/Misioni - Konventa parashikon forma moderne të bashkëpunimit midis palëve kontraktuese, siç janë analiza e përbashkët e kërcënimit, zyrtarët e ndërlidhjes, ndjekja e shpejtë (hot pursuit), mbrojtja e dëshmitarëve, vëzhgimi ndërkuftar, dorëzimi i kontrolluar, hetimet e fshehta për të hetuar krimin dhe për të parandaluar veprat penale, dërgimi dhe krahasimin i profileve të ADN-së dhe materialeve të tjera të identifikimit, masat teknike për lehtësimin e bashkëpunimit tejkuftar, operacione të

²⁷ Të gjitha informatat mbi PCC SEE janë marrë nga faqja e internetit <http://www.pccseesecretariat.si/>

kontrollimit kufitar, grupe të përbashkëta punuese për analiza, ekipe të përbashkëta të hetimit, patrulla të përbashkëta përgjatë kufirit shtetëror dhe bashkëpunim në qendra të përbashkëta. Zbatimi i plotë i Konventës në këtë mënyrë do të ndihmojë ato vende nënshkruese që nuk janë anëtare të BE-së për të përshpejtuar pranimin eventual të tyre.

Veprimtaritë kryesore për zbatimin e plotë të Konventës janë të bazuara në tri shtylla:

1. Procesi vendimmarrës – neni 33 i Konventës parashikon se komiteti i ministrave vendos për zbatimin, interpretimin dhe aplikimin e Konventës. Prandaj është me rëndësi të vendoset një proces efektiv, i plotë dhe i qartë i vendimmarrjes së komitetit të ministrave, të modeluar mbi praktikën e Bashkimit Evropian. Organet vendimmarrëse janë:

- Grupi punues i ekspertëve, roli i të cilit është të vëzhgojë aplikimin dhe zbatimin e Konventës dhe t'i japë rekomandime komitetit të ministrave. Deri më tani janë mbajtur pesë takime, i pari është mbajtur më 6 mars 2009 në Beograd, Serbi; i dyti më 29-30 qershor 2009 në Lubjanë, Slloveni; i treti më 19 maj 2010 në Sofje, Bullgari; i katërti më 16 shtator 2010 në Shkup, Maqedoni, dhe i pesti më 23-24 shkurt 2011 në Celje, Slloveni.
- Komiteti i ministrave ka rolin që të vendosë unanimisht mbi interpretimin, zbatimin dhe aplikimin e Konventës. Takimi i parë i komitetit është mbajtur më 17 korrik 2008 në Vjenë, Austri; takimi i dytë u organizua më 17 nëntor 2009 në Bruksel, Belgjikë; i treti

më 21 maj 2010 në Sofje, Bullgari; i katërti më 19 tetor 2010 në Bërdo pri Kranju, dhe i pesti më 28 shkurt 2011 në Lubjanë, Slloveni.

2. Programi i zbatimit - me përkrahjen e partnerëve ndërkombëtarë, palët kontraktuese janë duke përgatitur krijimin e aftësive operative për zbatimin e plotë të Konventës.

3. Bashkëpunimi operativ - Konventa në vetvete siguron një grumbull të mjeteve për bashkëpunim operativ, i cili në jetën e vërtetë duhet të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur.

Anëtarësia - më 5 maj 2006 në Vjenë, ministrat e punëve të brendshme nga Shqipëria, Bosnjë- Hercegovina, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Rumania dhe Serbia, nënshkruan Konventën për Bashkëpunim Policor për Evropën Juglindore. Konventa hyri në fuqi më 10 tetor 2007, pas ratifikimit nga të shtatë shtetet nënshkruese. Përveç tyre, Bullgaria, Austria, Hungaria dhe Sllovenia u anëtarësuan më vonë.

Struktura - Sekretariati i Konventës për bashkëpunim policor për Evropën Juglindore, i vendosur në Lubjanë, Slloveni, është themeluar me vendim të komitetit të ministrave në takimin e tyre më 17 korrik 2008 në Vjenë. Sekretariati, i organizuar dhe i përkrahur nga DCAF-i, u bë operativ më 1 shtator 2008. Personeli i DCAF-it në Lubjanë dhe personeli i deleguar nga palët kontraktuese (Austria dhe Sllovenia) bëjnë ekzekutimin e punëve të Sekretariatit. Kryesohet nga Austria nga 1 korriku deri më 31 dhjetor 2013, kryesues i radhës është Bosnjë- Hercegovina.

Mandati dhe detyrat e Sekretariatit, si dhe ndarja e burimeve të nevojshme financiare dhe njerëzore është paraparë në Memorandumin e mirëkuptimit mbi bashkëpunimin dhe përkrahjen në lidhje me sekretariatin, të nënshkruar nga ministrat e palëve kontraktuese dhe drejtori i DCAF-it.²⁸

Sekretariati i PCC SEE
Dunajska cesta 104
Lubjanë, Slloveni
T: +386 1 5609 300
F: +386 1 5609 303
E: info@pccseesekretariat.si

6.3 RACVIAC/ Qendra për Bashkëpunim në Fushën e Sigurisë në Evropën Juglindore²⁹ – Rakitje, Zagreb

Objektivi/Misioni - RACVIAC / Qendra për Bashkëpunim në Fushën e Sigurisë në Evropën Juglindore është pasues ligjor i Qendrës rajonale për asistim, verifikim dhe kontroll të armëve - organizatë ndërkombëtare, e pavarur, joprofitabile, në pronësi rajonale dhe akademike, e cila i përgjigjet organit të saj vendimmarrës politik, Grupit Këshillues Multinacional (MAG). Misioni i RACVIAC-it është nxitja e dialogut dhe bashkëpunimit për

²⁸

²⁹Të gjitha informatat mbi RACVIAC janë marrë nga faqja e internetit <http://www.racviac.org/>

çështjet e sigurisë në Evropën Juglindore përmes partneritetit në mes shteteve të rajonit dhe partnerëve të tyre ndërkombëtarë duke “transformuar të menduarit mbi çështjet e bashkëpunimit kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar të sigurisë; duke i ekspozuar pjesëmarrësit ndaj përfitimit të qasjeve bashkë-punuese mbi çështjet e sigurisë, kryesisht përmes konferencave, kurseve, seminareve dhe takimeve në RACVIAC, si dhe përmes trajnimeve gjuhësore dhe programeve të tjera të aplikueshme mbështetëse”. Programi vjetor i RACVIAC-it përqendrohet në tri shtylla kryesore: reformën e sektorit të sigurisë, marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, me një fokus të veçantë në organizatat euroatlantike, dhe mjedisit bashkëpunues për çështje të sigurisë, me një fokus në kontrollin e armëve. Për ndërtimin e profilit akademik, RACVIAC planifikon – seminare, punëtori dhe konferenca. Në mesin e temave të mbuluara në programin e tyre janë: transicioni i personelit ushtarak, konvertimi i bazës ushtarake, menaxhimi i burimeve të mbrojtjes, kontrolli demokratik i forcave të armatosura, reforma e sektorit të sigurisë, lufta kundër terrorizmit, bashkëpunimi për çështjet e sigurisë në rajon, menaxhimi i katastrofave/fatkeqësive, integrimi evropian dhe euroatlantik dhe kontrolli i armëve dhe CSBM.

Struktura - Grupi drejtues i RACVIAC-it - Qendra për Bashkëpunim për Sigurinë i përgjigjet organit të saj vendimmarrës politik, Grupit Këshillues Multinacional (MAG). MAG-u, si komitet drejtues i RACVIAC-it, përbëhet nga përfaqësuesit e anëtarëve, anëtarëve të asociuar dhe vëzhguesve. MAG-u ofron udhëheqjen për të

siguruar funksionimin dhe zhvillimin e RACVIAC-it, në përputhje me udhëzimet, parimet dhe vendimet e miratuara.

Anëtarësia - Marrëveshja e re mbi RACVIAC-in është nënshkruar më 14 prill 2010 nga Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Greqia, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia, dhe tani është në proces të ratifikimit. RACVIAC-i përkrahët financiarisht nga shtetet pjesëmarrëse të SEECP-së të përfaqësuara në MAG, si dhe nga shtetet e asociuara. Njëzet e nëntë shtete aktualisht janë të përfshira në RACVIAC dhe janë të ndara në:

Anëtarë - 9 shtete të SEECP-së - Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Greqia, Mali i Zi, Rumania, Serbia dhe Turqia.

Anëtare të asociuara - të gjitha shtetet e tjera të cilat dëshirojnë të mbështesin dhe të kontribuojnë në dialogun e sigurisë dhe të bashkëpunimit në Evropën Juglindore - Austria, Republika Çeke, Danimarka, Franca, Gjermania, Hungaria, Italia, Holanda, Norvegjia, Rusia, Sllovenia, Spanja, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar.

Vëzhgues - shtetet, institucionet apo organizatat e tjera, të cilat mund të marrin pjesë në veprimtaritë e RACVIAC-it si shtete vëzhguese pas aprovimit nga MAG-i - Kanadaja, Moldavia, Polonia, Sllovakia, Ukraina dhe SHBA-ja.

Përveç tyre, Belgjika, Irlanda, Letonia dhe Zvicra kanë shprehur interesimin e tyre për punën e RACVIAC-it. Anëtarë civilë dhe ushtarakë nga 10 shtete të përmendura më lart përbëjnë këtë

organ multinacional. Gjatë këtyre njëmbëdhjetë vjetëve RACVIAC-i ka qenë mikpritës i më shumë se 8.400 pjesëmarrësve nga e tërë Evropa dhe më larg, në më shumë se 270 veprimtari. I përshtatur për nevojat e rajonit, i pozicionuar në rajon dhe i përbërë nga personeli nga shtetet e rajonit, RACVIAC-i në mënyrë të përkryer mishëron shprehjen “në pronësi rajonale”. RACVIAC-i përkrahet financiarisht nga shtetet pjesëmarrëse të SEECp-së të përfaqësuara në MAG, si dhe nga shtetet e asociuara. Përbërja, detyrat, përgjegjësitë dhe procedurat e MAG-ut dhe financimi i tij janë të specifikuar në Termat e Referencës (ToR). Anëtarët dhe anëtarët e asociuar në mënyrë të barabartë marrin pjesë në diskutimet e MAG-ut, i cili merr vendimet e veta në bazë të konsensusit vetëm të anëtarëve.

RACVIAC - Qendra për Bashkëpunim në Fushën e Sigurisë
Stari hrast 53, Rakitje
HR-10437 Bestovje, Kroaci

Ndërtimi i kapitalit njerëzor

Kapitulli VII

Ndërtimi i kapitalit njerëzor

7.1 Task Forca e RCC-së për Edukimin dhe Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor³⁰ - Vjenë

Objektivi/Misioni - Task Forca e RCC-së për Edukimin dhe Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor (TF FBHC) ofron kornizën brenda së cilës do të vlerësojë nevojën dhe rëndësinë e BHC në shoqëritë në ndryshim, do të theksojë nevojën për të ndërlidhur edukimin, kërkimin dhe krijimin e politikave, dhe do të promovojë bashkëpunimin rajonal në fushën e zhvillimit të kapitalit njerëzor. Qëllimi tjetër është për të maksimizuar përfitimet e investimit në zhvillimin e kapitalit njerëzor përmes kontributit të saj në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social duke siguruar lidhje logjike me veprimet e tjera të promovuara në nivel rajonal dhe kombëtar.

Anëtarësia - Anëtarësia e Task Forcës përbëhet nga pjesëmarrësit e bordit të RCC-së, të sekretarit të përgjithshëm të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, të vendeve nënshkruese të Memorandumit të mirëkuptimit të vitit 2007 në Stamboll, të vendeve anëtare të nismës së reformës së arsimit në Evropën Juglindore dhe të

³⁰ Të gjitha informatat mbi RCC Task force FBHC janë marrë nga faqja e internetit <http://www.taskforcehumancapital.info>

vendeve anëtare të platformës drejtuese për kërkim për shtetet e Ballkanit Perëndimor.

Struktura - Task Forca udhëhiqet nga një ekip qendror i përbërë nga kryesuesi dhe nga 2 bashkëkryesues të zgjedhur me konsensus. Pozita e kryesuesit dhe e bashkëkryesuesve udhëhiqet nga përfaqësuesit e anëtarëve themelues të Task Forcës. Të gjithë anëtarët themelues kanë të drejtë të kryesojnë dhe të bashkëkryesojnë Task Forcën mbi baza të barabarta. Kohëzgjatja e mandatit është dyvjeçar. Mandati i parë dhe i dytë, pas miratimit të Task Forcës nga RCC-ja, janë siguruar nga Rumania, si kryesuese, dhe nga Austria dhe Kroacia, si bashkëkryesuese.

Sekretariati i Task Forcës në Vjenë

Marija Sonoda

KulturKontakt Austria

marija.soronda@kulturkontakt.or.at

7.2 Nisma për kërkime arsimore në Evropën Juglindore (ERI SEE)³¹ - Beograd

Objektivi/Misioni - Nisma për kërkime arsimore në Evropën Juglindore (ERI SEE) është një platformë rajonale për bashkëpunim në fushën e arsimit dhe të trajnimit. Ajo synon të mbështesë

³¹ Të gjitha informatat mbi ERI SEE janë marrë nga faqet e internetit <http://www.erisee.org/node/5> dhe www.cep.edu.rs

reformat kombëtare në arsim dhe trajnim nëpërmjet ndërtimit të kapaciteteve rajonale, transferimit të “know-how” dhe ndërlidhjes së këtyre përpjekjeve me kornizat evropiane për zhvillimin e arsimit. ERI SEE bazohet në memorandumun e mirëkuptimit të nënshkruar nga ministrat e arsimit, shkencës dhe të kërkimit të Evropës Juglindore. Struktura e saj institucionale përbëhet nga bordi drejtues, organi konsultativ dhe sekretariati. ERI SEE është në fazën e tranzicionit të selisë së saj nga Zagrebi në Beograd dhe krijimit të sekretariatit të saj të përhershëm. Si anëtar i bordit drejtues të ERI SEE, RCC-ja ofron këshilla dhe mbështet procesin e institucionalizimit të ERI SEE dhe sekretariatit të saj. Pas përfundimit të procedurave aprovuese për ratifikimin e marrëveshjes për vendin mikpritës mbi themelimin e ERI SEE dhe sekretariatit të saj, pason procedura e përzgjedhjes për personelin e sekretariatit të ERI SEE. Ideja për zhvillimin e tri grupimeve rajonale të dijes nën ombrellën e ERI SEE është përkrahur nga RCC-ja, i cili pranoi mundësinë që grupimet të bëhen veprimtari rajonale të cilat do të zbatoheshin nga ERI SEE, ndoshta nën ombrellën e platformës së BE-së për arsim dhe trajnim në Ballkanin Perëndimor.

Anëtarësia - Shtetet anëtare (nënshkruese të Memorandumit të mirëkuptimit për rolin dhe organizimin e ERI SEE, Bërdo 2010): Shqipëria, Ministria e Arsimit dhe Shkencës; Bosnjë- Hercegovina: Ministria për Çështje Civile; Kroacia: Ministria e Shkencës, Arsimit dhe Sportit; Mali i Zi: Ministria e Arsimit dhe Sportit; Moldavia: Ministria e Arsimit; Maqedonia: Ministria e Arsimit dhe Shkencës; Serbia: Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Vëzhgues: Kosova: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Bullgaria: Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Shkencës; Rumania: Ministria e Arsimit dhe Kërkimit.

Partnerët institucionalë: Fondacioni Evropian për Trajnime (ETF), Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), Shoqata Evropiane e Universiteteve (EUA), Këshilli i Evropës (CoE), Task Forca për Edukimin dhe Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor, Këshilli për Bashkëpunim Rajonal.

Struktura - Struktura institucionale e ERI SEE përbëhet nga bordi drejtues i ERI SEE, nga një organ konsultativ dhe nga sekretariati i ERI SEE (agjencia). Bordi drejtues përbëhet nga një përfaqësues nga secila palë nënshkruese e Memorandumit të mirëkuptimit në Bërdo, një përfaqësues i RCC-së, një përfaqësues i TFBHC, si dhe një përfaqësues i shteteve dhe institucioneve donatore, respektivisht që kontribuojnë minimumin e shumës së përcaktuar në shtojcën 1 të Memorandumit të mirëkuptimit në Bërdo. Anëtarët e bordit drejtues takohen dy herë në vit dhe janë përgjegjës për zhvillimin e politikave të përgjithshme të nismës, strategjitë e përgjithshme të saj dhe për adoptimin e programeve dhe raporteve të punës të ERI SEE. Bordi drejtues mbështetet nga organi konsultativ i ERI SEE, organ me rol këshillëdhënës ku institucionet partnere të ERI SEE mbajnë një vend, si dhe nga donatorët e nismës. Deri në gjysmën e vitit 2010, Agjencia e ERI SEE ishte e vendosur në Zagreb dhe ishte përgjegjëse për zbatimin e programeve të punës, të cilat janë rezultat i vendimeve të marra nga bordi drejtues në bashkëpunim me organin konsultativ, në

bazë të propozimeve të bëra nga anëtarët e bordit drejtues dhe drejtori ekzekutiv i agjencisë. Aktualisht Qendra për Politikën Arsimore (CEP) është institucion, i cili do të mirëpresë agjencinë e ERI SEE gjatë periudhës kalimtare, para hapjes së sekretariatit të ri të ERI SEE në Beograd, Serbi. Programet e punës zbatohen nëpërmjet instrumenteve të llojit të punëtorive, seminareve dhe trajnimeve tematike, vizitave studimore dhe binjakëzimit të institucioneve. Shtetet anëtare në ERI SEE, sipas Memorandumit të mirëkuptimit, kontribuojnë financiarisht në baza vjetore në buxhetin e sekretariatit të ERI SEE me shumën e cila është llogaritur në bazë të metodologjisë së zhvilluar për kontribute në RCC.

CEP Interim Agency of ERI SEE
Svetozara Markovića 22
11000 Beograd, Serbia
Telefon / faks: +381 11 32 30 105
Email: cep@cep.edu.rs

7.3 Shkolla Rajonale e Administratës Publike (ReSPA)³² - Danilovgrad

Objektivi/Misioni – ReSPA është një organizatë ndërkombëtare së cilës i është besuar misioni i nxitjes së bashkëpunimit rajonal në fushën e administratës publike në Ballkanin Perëndimor. Si e tillë, ReSPA është një përpjekje unike historike, e themeluar për të mbështetur krijimin e një sistemi të përgjegjshëm, efektiv dhe profesional të administratës publike për Ballkanin Perëndimor në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE.

ReSPA synon që të arrijë këtë mision nëpërmjet organizimit dhe shpërndarjes së veprimtarive, konferencave të nivelit të lartë, ngjarjeve të rrjetëzimit dhe publikimeve, objektiv i përgjithshëm i të cilave është bartja e njohurive dhe shkathtësive të reja, si dhe lehtësimin e shkëmbimit të përvojave brenda rajonit dhe në mes rajonit dhe shteteve anëtare të BE-së. Shkolla rajonale e administratës publike u hap në nëntor të vitit 2010, me qëllimin kryesor për të përmirësuar bashkëpunimin rajonal në fushën e administratës publike, në forcimin e kapaciteteve administrative, siç kërkohet nga procesi i integritit evropian, dhe në zhvillimin e burimeve njerëzore në përputhje me parimet e hapësirës administrative evropiane. Struktura dhe objektet e saj ofrojnë kushte të favorshme për organizimin e kurseve afatshkurtra, të

³² Të gjitha informatat mbi ReSPA janë marrë nga faqja e internetit www.respaweb.eu

cilat do të organizohen në bashkëpunim me organizatat e njohura ndërkombëtare dhe me ekspertë të njohur dhe të pavarur nga rajoni dhe BE-ja. Duke ndihmuar në përmirësimin e administratës publike, ReSPA do të ketë një ndikim të tërthortë në rritjen e sundimit të ligjit dhe të transparencës. Komunikimi i përmirësuar dhe shkëmbimi i informatave mbi veprimtaritë e interesit të ndërsjellë do të forcojnë bashkëpunimin e ardhshëm midis dy organizatave, në këtë mënyrë do të orientojnë përpjekjet rajonale në forcimin e kapaciteteve kombëtare dhe në shmangien e duplifikimeve.

Anëtarësia – Anëtarët e ReSPA-së janë kryesisht zyrtarë të shteteve, të cilat kanë nënshkruar dhe ratifikuar marrëveshjen për krijimin e Shkollës rajonale të administratës publike (Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia), si dhe subjekte të tjera në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Aktivitetet e ReSPA-së gjithashtu janë të hapura për zyrtarë nga shtete dhe institucione të tjera. Zyrtat e ReSPA-së janë të vendosura në Danilovgrad, Mal të Zi, me objekte trajnimi dhe kampusin. Gjashtë anëtarët e ReSPA-së kontribuojnë çdo vit me 150.000 euro.

Struktura - Bordi drejtues është organi më i lartë vendimmarrës i ReSPA-së. Përgjegjësitë e bordit drejtues përfshijnë ofrimin e udhëzimeve të përgjithshme të politikave për ReSPA-në dhe miratimin e planit vjetor të biznesit të ReSPA-së, duke përfshirë programin e saj të punës dhe buxhetin. Ai përbëhet nga përfaqësuesit e secilit anëtar të ReSPA-së, të cilët vijnë nga ministritë ose autoritetet ekuivalente përgjegjëse për

administratën publike, zhvillimin e burimeve njerëzore apo integrimin evropian. Përveç tyre, edhe Komisioni Evropian mund të dërgojë një përfaqësues për të marrë pjesë në takimet e bordit drejtues, si dhe drejtori i ReSPA-së mund të vendosë (apo t'i kërkohet nga bordi drejtues) të marrë pjesë në takime. Po ashtu, përfaqësues nga shtete dhe organizata të tjera, si dhe ekspertë individualë mund të ftohen që të marrin pjesë në takimet e bordit drejtues. Bordi drejtues normalisht punon me konsensus. Në rast se konsensusi nuk mund të arrihet, një vendim mund të merret me anë të votimit, me ç'rast çdo anëtar i ReSPA-së e ka një votë. Vetëm anëtarët e ReSPA-së kanë të drejtë të votojnë. Bordi drejtues takohet së paku pesë herë në vit. Konkretisht, në nivel ministrash së paku një herë në vit dhe në nivel të zyrtarëve të lartë së paku katër herë në vit. Këta zyrtarë të lartë janë gjithashtu përfaqësues të përhershëm të anëtarëve në bordin drejtues.

Shkolla Rajonale e Administratës Publike

Branelovica

81410 Danilovgrad

Mali i Zi

+382 (0)20 817 200

+382 (0)20 817 238

respa-info@respaweb.eu

Bashkëpunimi parlamentar

Kapitulli VIII

Bashkëpunimi parlamentar – si një temë horizontale

8.1 Kryetarët e Parlamentit të shteteve të SEECP-së³³

Objektivi/Misioni - Ky është forumi më i lartë i bashkëpunimit parlamentar në Evropën Juglindore. Ai organizohet nga shteti që mban për një vit kryesimin e Zyrës së SEECP-së dhe është përgjegjës për përgatitjen e të gjitha dokumenteve të nevojshme dhe për vendimin e takimit. Objektivat kryesore të këtij forumi, siç përcaktohet në tri dokumentet e saj kryesore, janë: forcimi i mëtejshëm i institucioneve demokratike në rajonin e Evropës Juglindore, dhe bashkërendimi i përpjekjeve të parlamenteve kombëtare në mbështetje të RCC-së dhe SEECP-së; nxitja e ndërtimit të mëtejshëm të kapaciteteve dhe forcimi institucional i parlamenteve të shteteve të Evropës Juglindore; nxitja e shkëmbimit të informatave, përvojave dhe praktikave më të mira midis parlamenteve kombëtare të shteteve të Evropës Juglindore në të gjitha nivelet (p.sh: kryetarët e parlamenteve, komitetet, stafin parlamentar); dhe përpjekja e mëtejshme për të inkurajuar dhe ndihmuar parlamentet e Evropës Juglindore drejt

³³ Të gjitha informatat mbi folësit e parlamentit SEECP janë marrë nga faqja e internetit <http://rspcsee.org/en/pages/read/seecp-parliamentary-dimension>

harmonizimit të legjislacionit të tyre me *acquis communautaire* dhe standardet e tjera të BE-së dhe ato ndërkombëtare.

Anëtarësia - Shtetet anëtare të SEECP-it

Struktura – Kryesuesi i radhës organizon takimin vjetor të kryetarëve të Parlamentit

8.2 Sekretariati Rajonal për Bashkëpunim Parlamentar në Evropën Juglindore (RSPC SEE)³⁴ - Sofje

Sekretariati Rajonal për Bashkëpunim Parlamentar në Evropën Juglindore (RSPC SEE) është themeluar pas miratimit të takimit të kryetarëve të Parlamentit të SEECP-së në vitin 2008, pas nënshkrimit të Memorandumit të mirëkuptimit, dhe vendimit për ta vendosur atë në Kuvendin kombëtar të Bullgarisë. Sekretariati rajonal kishte për qëllim që të jetë pikë kryesore, e cila do të bashkërendonte të gjitha veprimtaritë e bashkëpunimit parlamentar rajonal në mes shteteve pjesëmarrëse të SEECP-së. RSPC SEE-ja merr pjesë në përgatitjen e programit parlamentar vjetor të SEECP-së në konsultim me kryesuesin e radhës, SEECP Trojkan, me parlamentet kombëtare dhe me RCC-në. Ai gjithashtu ka qenë i përfshirë në procesin e institucionalizimit të dimensionit parlamentar të SEECP-së dhe ka kontribuar në veprimtaritë e grupit punues të saj. RSPC-ja gjithashtu është pikë kontakti për

³⁴ Të gjitha informatat mbi RSPC SEE-në janë marrë nga faqja e internetit <http://rspcsee.org/en/pages/read/seeep-parliamentary-dimension>; www.rcc.int

bashkëpunim me Parlamentin Evropian dhe organizatat parlamentare ndërkombëtare. Në proces është një debat mbi transformimin e RSPC-së. Dy modele janë iniciuar: që RSPC-ja të transformohet në një sekretariat parlamentar dhe, sipas modelit tjetër, në një sekretariat ndërkombëtar. Struktura e re do të zgjerojë funksionet e veta si një organ ekspert, operativ dhe teknik, dhe si pikë kontaktuese me shtetin që mban kryesimin e Zyrës së SEECP, SEECP Trojkan, me komitetin e përhershëm dhe me sekretarët e delegacioneve kombëtare.

8.3 COSAP-Konferenca për Ballkanin Perëndimor e Komisioneve Parlamentare të Integritimit Evropian të shteteve pjesëmarrëse në Procesin e Stabilizim-Asociimit³⁵

Objektivi/Misioni – COSAP-i për Ballkanin Perëndimor është krijuar në Sarajevë më 16-18 qershor të vitit 2005, si rezultat i Samitit të Selanikut të mbajtur në vitin 2003, ku të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor u dha perspektiva e anëtarësimit pasi ata individualisht të kenë plotësuar kriteret e pranimit. COSAP-i për Ballkanin Perëndimor ka një agjendë dhe perspektivë të qartë; ajo synon fuqizimin e bashkëpunimit midis komisioneve të parlamenteve kombëtare që merren me çështjet evropiane.

³⁵ Të gjitha informatat mbi COSAP-in për Ballkanin Perëndimor janë marrë nga faqja e internetit <http://www.stabilitypact.org/wt1/pcarchives.asp>; <http://rspcsee.org/en/pages/read/eu-integration/cosap>

RCC-ja ka marrë pjesë në të gjitha veprimtaritë e COSAP-it dhe e ka ndjekur punën e saj. Puna dhe agjenda e kësaj strukture është shumë e ngjashme me veprimtarinë e Forumit Parlamentar të Cetinës (CPF) dhe në të ardhmen ajo mund të integrohet në këtë strukturë.

Anëtarësia - Shtetet e Ballkanit Perëndimor që marrin pjesë në Procesin e Stabilizim-Asociimit përveç Kosovës.

Struktura - Sipas rregullave të punës së COSAP-it për Ballkanin Perëndimor, të miratuara në takimin e parë të mbajtur në Sarajevë në vitin 2005, konferenca ka kryesinë e radhës (rotative), të mbajtur në rend alfabetik nga kryesuesi i Komisionit për çështje evropiane të vendit kryesues dhe mblidhet së paku dy herë në vit për të diskutuar çështjet që lidhen me Procesin e Stabilizim-Asociimit dhe të zgjerimit të BE-së. Takimet planifikohen zakonisht duke marrë parasysh edhe kalendarin e takimeve të Konferencave të komisioneve parlamentare për Çështje të Bashkimit Evropian të parlamenteve të Bashkimit Evropian - COSAC-it dhe organizohen dhe priten nga vendi kryesues. Një treshe e përbërë nga kryetarët e komisioneve për çështjet e integrimit evropian të Presidencës së mëparshme, aktuale dhe të ardhshme siguron bashkërenditjen e veprimtarive. Ajo nuk ka sekretariat, por funksionon përmes rotacionit të parlamenteve kryesuese.

8.4 Forumi Parlamentar i Cetinës (CPF)³⁶ - Podgoricë

Objektivi/Misioni - Forumi Parlamentar i Cetinës është një nismë e ndërmarrë që nga viti 2004 nga Parlamenti i Malit të Zi për të inkurajuar dhe promovuar dialogun e bashkëpunimin parlamentar midis shteteve të rajonit. Forumi Parlamentar i Cetinës ofron mundësinë për të ndarë përvojat dhe praktikat më të mira dhe për të racionalizuar punën parlamentare, veçanërisht në lidhje me zbatimin e standardeve të BE-së në legjislacionin kombëtar dhe në çështjet e tjera të interesit të përbashkët rajonal. Për këtë qëllim, dhe në mënyrë që të promovojë një dialog më të afërt dhe më të përqendruar, Forumi Parlamentar i Cetinës organizon takime, në të cilat mbledhen së bashku përfaqësuesit e parlamenteve në nivele të ndryshme: kryetarët e parlamentit dhe/ose zëvendëskryetarët e parlamentit; kryetarët/kryesuesit e komisioneve parlamentare; deputetët; sekretarët e parlamentit; sekretarët e komisioneve parlamentare dhe ekspertët bashkëpunëtorë.

Anëtarësia - Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Kosova dhe Turqia.

³⁶ Të gjitha informatat mbi CPF-në janë marrë nga faqja e internetit <http://www.stabilitypact.org/wt1/CetinjeParliamentaryForum.asp>; <http://www.rcc.int/articles/0/100/support-to-cetinje-parliamentary-forum-to-give-regional-parliaments-a-greater-voice-in-preparing-for-eu-accession>; <http://www.skupstina.me/index.php/en/medjunarodna-saradnja/regionalne-inicijative/regionalne-inicijative/107-medjunarodna-saradnja/224-cetinjski-parlamentarni-forum-cpf>

Struktura - Ndërsa COSAP-i mbahet vetëm në nivel të komisioneve parlamentare që merren me çështjet evropiane, Forumi Parlamentar i Cetinës ka një fushëveprim më të gjerë të veprimtarive, të cilat gjithashtu prekin komisionet e tjera parlamentare. Forumi po ashtu organizon takimet e dimensionit parlamentar të nismës së Adriatikut-Jonit.

Dekada Rome

Kapitulli IX

Dekada Rome

9.1 Dekada e përfshirjes së romëve 2005 – 2015 - Dekada Rome³⁷ - Budapest

Ka presidencë rotative, gjithashtu ka edhe sekretariatit: aktualisht është Podgorica, Mali i Zi. Ndërsa Sekretariati i Dekadës së përfshirjes së Romëve është në Budapest, Hungari.

Objektivi/Misioni - Dekada e përfshirjes së Romëve 2005–2015 është një angazhim i jashtëzakonshëm politik i qeverive evropiane për të eliminuar diskriminimin ndaj romëve dhe për të mbyllur boshllëqet e papranueshme midis romëve dhe pjesës tjetër të shoqërisë. Dekada përqendrohet në fushat me prioritet, si në arsim, punësim, shëndetësi dhe strehim, dhe angazhon qeveritë të marrin parasysh çështjet e tjera themelore, varfërinë, diskriminimin dhe barazinë gjinore. Dekada është një nismë ndërkombëtare, e cila bashkon qeveritë, organizatat ndërqeveritare dhe joqeveritare, si dhe shoqërinë civile romë.

Objektivat kryesore të Dekadës janë që të: përshpejtojnë përparimin drejt përmirësimit të mirëqenies së romëve, duke

³⁷ Të gjitha informatat mbi Dekadën Rome janë marrë nga faqja e internetit <http://www.romadecade.org/>

përfshirë romët në procesin e vendimmarrjes, dhe të rishikojë përparimin e tillë në një mënyrë transparente dhe të matshme. Dekada mbështet dhe mban përqendrimin e përbashkët të qeverive pjesëmarrëse, organizatave ndërkombëtare dhe romëve në arritjen e përparimit drejt rezultateve të përzgjedhura përgjatë dhjetë vjetëve. Suksesi i Dekadës demonstron duke matur përparimin e bërë për përfshirjen e romëve dhe sidomos përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre gjatë periudhës dhjetëvjeçare.

Anëtarësia - Dymbëdhjetë shtetet që aktualisht marrin pjesë në Dekadë janë: Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Republike Çeke, Hungaria, Maqedonia, Mali i Zi, Rumania, Serbia, Sllovakia dhe Spanja.

Vëzhguese: Sllovenia dhe Shtetet e Bashkuara.

Organizatat partnere ndërkombëtare të Dekadës janë organizatat ndërqeveritare dhe ndërkombëtare në vazhdim: Banka Botërore, Instituti për Shoqëri të Hapur (OSI), Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), Këshilli i Evropës (CoE), Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës (CEB), Pika Kontaktuese për Romët dhe Çështjet Sinti (CPRSI), Zyra për Institucione Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut (ODIHR) të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE), Zyra Informativ Evropiane e Romëve (ERIO), Forumi Evropian i Romëve dhe i Udhëtarëve (ERTF), Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve

(ERRC) dhe Fondi për Arsimimin e Romëve (REF). Kuota e anëtarësisë është 20.000 euro për qeveritë pjesëmarrëse.

Struktura

Dekada e Romëve udhëhiqet nga organet në vazhdim:

Komisioni Drejtues Ndërkombëtar (ISC)

ISC-ja përbën organin më të lartë vendimmarrës dhe bashkërendues të Dekadës. ISC-ja do të përbëhet nga të gjitha qeveritë pjesëmarrëse dhe të gjitha organizatat partnere ndërkombëtare, dhe nga përfaqësuesit e shoqërive civile kombëtare të romëve.

Presidenca e Dekadës

Për çdo vit një qeveri do të shërbejë në funksion të Presidencës së Dekadës.

Presidenca e Dekadës do të ndërrohet çdo vit në mes qeverive.

Tri kryesimet e fundit të Presidencës janë: Kroacia 1 korrik 2012 - 30 qershor 2013; Mali i Zi 1 korrik 2013 - 30 qershor 2014; 1 korrik 2014 - 30 qershor 2015 — Bosnjë-Hercegovina.

Sekretariati i Presidencës së Dekadës - Sekretariati ndërrohet ndërmjet qeverive pjesëmarrëse për çdo vit bashkë me Presidencën e Dekadës. Qeveria e cila mban Presidencën e Dekadës siguron që sekretariati të ketë personel të mjaftueshëm

dhe të jetë i pajisur në mënyrë të përshtatshme për kryerjen e aktiviteteve të caktuara të tij.

Fondi i Mirëbesimit i Dekadës (DTF) është themeluar me qëllim të financimit të aktiviteteve ndërkombëtare të Dekadës, sipas dispozitave të përcaktuara në marrëveshjet e fondit të mirëbesimit të Dekadës midis qeverive përkatëse dhe Bankës Botërore. Fondi mund të financojë veprimtaritë ndërkombëtare dhe ndihmën teknike të qeverive pjesëmarrëse, siç janë ndërgjegjësimi dhe komunikimi ndërshtetëror, monitorimi dhe vlerësimi, informimi, shpërndarja dhe menaxhimi i njohurive.

Fondi kapitalizohet nga kontributet vjetore të qeverive pjesëmarrëse dhe organizatave ndërkombëtare dhe do të përcaktohet në një minimum prej 20.000 eurosh për vitin 2006. Për secilin vit pasues ISC-ja do të vendosë mbi shumën e kontributit vjetor. Organizatat ndërkombëtare kontribuojnë në Fondin e Mirëbesimit në përputhje me misionin dhe rregullat e tyre. Një organizatë ndërkombëtare do të marrë përgjegjësinë për ekzekutimin e DTF-së. Struktura udhëheqëse e DTF-së do të përcaktohet në kushtet e veçanta të referencës të bashkëngjitur në marrëveshjet mbi Fondin e Mirëbesimit të Dekadës midis qeverive përkatëse dhe Bankës Botërore.

Fondacioni i Sekretariatit të Dekadës së Përfshirjes së Romëve

Teréz krt. 46 H-1066 Budapest, Hungari

Tel: +36-1-411-1325; +36-1-269-1203

Fax: +36-1-411-1326

E-mail: info@romadecade.org

Lista e referencave

<http://www.rcc.int>

<http://www.stabilitypact.org>

<http://rspcsee.org>

<http://www.seeic.rcc.int>

<http://www.cefta.int>

<http://www.energy-community.org>

<http://www.seetoint.org>

<http://www.seeic.rcc.int>

<http://www.energy-community.org>

<http://www.swg-seerural.org>

<http://ec.europa.eu/transport>

<http://www.rai-see.org>

<http://www.marri-rc.org>

<http://www.secicenter.org>

<http://www.dppei.info>

<http://www.pccseesecretariat.si>

<http://www.racviac.org>

<http://www.taskforcehumancapital.info>

<http://www.erisee.org>

<http://www.cep.edu.rs>

<http://www.respaweb.eu>

<http://www.skupstina.me>

<http://www.romadecade.org>

Shtojca

Kapitulli X

Shtojca I

Pjesëmarrja e Kosovës në nismat rajonale³⁸

Kompakti i investimeve	1	Komisioni Ndërkombëtar i Pellgut të Lumit Sava
Qendra e Evropës Juglindore për Mësim-nxënie të Ndërmarrësisë	2	Rrjeti i Grave Ndërmarrëse
Grupi i Përherëshëm Punues për Zhvillim Rural Rajonal në Evropën Juglindore	3	Qendra për Bashkëpunim të Sigurisë (RACVIAC)
Qendra për Zhvillimin e Qeverisjes Elektronike	4	Nisma Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI)
Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Lokale në Evropën Juglindore	5	Qendra Rajonale e Punëdhënësve të Adriatikut (AREC)
Iniciativa Elektronike e Evropës Juglindore + Iniciativa Broadband e Evropës Juglindore	6	Qendra Rajonale Mjedisore për Evropën Jugore dhe Qendrore (REC)

³⁸ Në kolonën e anës së majtë janë nismat rajonale ku Kosova është pjesëmarrëse; në kolonën e anës së djathtë janë nismat rajonale ku Kosova kërkon anëtarësimin – kjo tabelë është siguruar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës

Rrjeti Mjedisor Rajonal për Anëtarësim	7	Bordi Këshillëdhënës i Prokurorëve të Evropës Juglindore (SEEPAG)
Task Forca për Edukimin dhe Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor	8	Nisma Rajonale për Migracionin, Refugjatët dhe Azilin (MARRI)
Marrëveshja për Hapësirën e Përbashkët Evropiane	9	Konventa për Bashkëpunim Policor (PCCSEE)
Sekretariati i Programit ISIS (ECAA)	10	Nisma për Përgatitje dhe Parandalim të Katastrofave/fatkeqësive
Observatori i Transportit i Evropës Juglindore (SEETO)	11	Rrjeti për Shëndetësi i EJT-së (SEEHN)
Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC) – Pozitive (27.02.2013)		
Komuniteti për energji		
CEFTA dhe marrëveshjet dypalëshe për tregti të lirë (UNMIK)		

Shtojca II: teksti i marrëveshjes për përfaqësim rajonal të Kosovës

Marrëveshjet në lidhje me përfaqësimin dhe bashkëpunimin rajonal

1. Të dyja palët konfirmojnë përkushtimin për bashkëpunim efektiv, përfshirës dhe përfaqësues rajonal.
2. Në këtë kuptim 'Kosova*' është i vetmi emërtim që do të shfrytëzohet në kuadër të bashkëpunimit rajonal.
3. Fusnota që do të zbatohet krahas yllthit në paragrafin 2 më lart do të jetë: "Ky emërtim nuk ndikon në qëndrimin për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të KB-së dhe me mendimin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës."
4. 'Kosova*' merr pjesë e pavarur dhe flet në emër të vet në të gjitha tubimet rajonale.
5. Kur të arrihen marrëveshje të reja ose nënshkrime, përfaqësuesi i 'Kosovës*' do të nënshkruhet nën emërtimet e përshkruara nën paragrafët 2 dhe 3 më lart.
6. Sa u përket ndryshimeve të marrëveshjeve që i ka nënshkruar UNMIK-u, asnjëri nga këto konkluzione nuk do të interpretohet në dëm të rregullativës ligjore të UNMIK-ut. Përfaqësuesi i UNMIK-ut do të ftohet në takimet që organizohen në kuadër të

marrëveshjeve në të cilat është nënshkrues. Është në të drejtën e UNMIK-ut të vendosë nëse do të marrë pjesë në cilindo takim.

7. Organizuesi i takimeve do të inkurajohet të evitojë vënien e simboleve kombëtare me përjashtim të simbolit të vet dhe të BE-së, duke marrë parasysh statusin e organizatave relevante.

8. BE-ja si ndërmjetës do të njoftojë organizatat dhe entitetet relevante rajonale për këto marrëveshje emërtimi, përfaqësimi dhe nënshkrimi. Ato duhet të pasqyrohen në organizimin praktik të takimeve rajonale. BE-ja do të mbikëqyrë zbatimin e këtyre marrëveshjeve.

9. Të dyja palët dhe BE-ja do të nxisin partnerët që të përkrahin këto marrëveshje dhe do të ndihmojnë në zbatimin e tyre.

10. Organizatat rajonale të cilave u referohen konkluzionet janë organizatat e tashme dhe të ardhshme ndërqeveritare ose marrëveshjet, qëllimi i të cilave është të promovojnë bashkëpunimin ose integrimin në rajonin e Ballkanit. "Takimet rajonale" përfshijnë takimet e këtyre organizatave e edhe takimet ad-hoc ose ato joformale me qëllim të ngjashëm. Po ashtu përfshijnë takimet me institucionet e BE-së në kuadër të agjendës evropiane.

11. Këto marrëveshje janë miratuar në bazë të përkohshme.